

Atë. Robert DeGrandis S. S. J.  
Dhurata e Profecisë

Titulli i origjinalit:  
The gift of prophecy

Përktheu e përshtati:  
Gjon Kelmendi ida

Redaktimi gjuhësor:

-----

Kopertina:

-----



Atë Robert DeGrandis S. S. J.

# Dhurata e Profecisë

## Parathënie botimit shqip

„Atë ditë të shurdhët do t'i dëgjojnë fjalët e librit, të çliruar nga errësira e terri, do të shohin sytë e të verbërve. Gëzim mbi gëzim do të kenë në Zotin të varfrit, në shenjtin e Izraelit do të gëzojnë më skamnorët.“ (Isaia 29, 18-19)

Pas territ shekullor dhe vuajtjeve të pafund, a thua nuk është koha që edhe populli shqiptar të dëgjojë këto fjalë trimëruese dhe t'i kthehet Zotit të vet, që t'i brohorasë dhe ta lavdërojë me gjithë zemër.

Pas librit mbi dhuratën e gjuhëve, e cila konsiderohet „si derë“ për të hyrë në dhuratat tjera të Shpirtit Shenjt, lexuesit i ofrohet ky libër mbi dhuratën e profecisë. Ky është realitet i përditshmërisë në kishën tonë katolike në mbarë botën, sidomos atje ku janë mbajtur seminarët e ungjillëzimit të ri, që nuk është diçka e panjohur edhe në mesin tonë, pasi që disa kanë pasur mundësi të përjetojnë përtëritjen e jetës së tyre shpirtërore, të pranojnë dhurata të ndryshme të Shpirtit Shenjt si dhe shërime të shumta shpirtërore e fizike.

Profeti Isaia më tej thotë:

Le të gëzojnë vendet e shkreta e të papërshkueshme  
Le të galdojë shkretëtira e të lulëzojë si lili...  
Do ta shohin lavdinë e zotit,  
Shkëlqimin e hyjit tonë!...  
Përtëritni në fuqinë e duarve të lodhura,  
Fuqi jepuni gjunjëve të marrakotur  
Thoni atyre që i ka lëshuar zemra:  
„mbahuni! Frikë mos kini!...  
Atëherë sytë do t'u çelen të verbërve,  
Veshët e të shurdhërve do të dëgjojnë;  
Atëherë i shqepi do të kërcejë si dreri  
Gjuha e të pagojit do të shpërthejë në hare,... (is 35)

Këtu do të jap dëshminë time:

Pas tetë vitesh shërbimi në Kosovë (Dunav), në vitin 1982 i luta të parët e rregullit që të më marrin në Zagreb për një vit ose dy që të përtërihem shpirtërisht dhe të njihem me lëvizjet e reja në kishë. E doja këtë gjë jo vetëm për vete, por edhe për të tjerët, në mënyrë që t'i sillja njerëzit te Jezusi ashtu si na mëson Kisha.

Në vitin 1983, në kishën e shën Markut në Zagreb u mbajt seminari, të cilin e udhëhoqën karizmatikët botërorë dhe prof. Tomislav Ivançiq, në të cilin mori pjesë edhe Dedë Palokaj, që udhëheq bashkësinë e lutjes në Prishtinë. Në atë seminar u panë dhe

përjetuan shumë dhurata, por për mua ishte veçanërisht e rëndësishme ajo e profetizimit. Në atë seminar ishte një profeci, të cilën një kohë të gjatë nuk mund ta pranoja: „ja, po i këpus prangat mbi këtë popull dhe së shpejti kishat do të bëhen si vatra të vogla dhe ajo valë e zgjimit religjioz do të përfshijë mbarë tokën, Hungarinë, Bullgarinë, Rumaninë dhe Shqipërinë.“ Kur filloi lëvizja demokratike në Hungari, u pendova dhe kërkova të falur prej Jezusit, sepse Ai e kishte thënë atë nëpërmes profecisë.

Atëherë isha e sigurt se do të bjerë komunizmi, se unë do të shkoja në Shqipëri, gjë e cila ndodhi në gushtin e vitit 1991. Nën nxitjen dhe fuqinë e Shpirtit Shenjt, isha e para motër e bashkësisë sime që hyri në atë vend aq tërheqës për mua, të shkatërruar deri në ata masë, sa që trenat dhe autobusët ishin pa dyer e dritare.

Kur hyra në një autobus të tillë që të vizitoj një fshat afër Tiranës, më thanë: „Motrës së Nënë Tereze nuk do t'i marrim të holla për biletë!“ (Në fillim të gjitha „ishim motra të Nënës Terezë“, sepse nuk na dallonin.) Një varfëri e paskajshme, një vuajtje aq e madhe, por populli nuk kishte rënë shpirtërisht dhe i kishte ruajtur vlerat e veta të mrekullueshme. Kur u ktheva dhe entuziazmin tim ua përcolla motrave, tri prej nesh ua drejtuam lutjen të parëve të bashkësisë që të na lejojnë të shkojmë në Shqipëri. Pas gjashtë muajsh ata vizituan Shqipërinë dhe u morën vesh për misionin në Laç, kurse pas një viti filluam misionin katër motra: dy kosovare dhe dy kroate.

Nuk kishte mbetur kryq as në varre e në kishën më të madhe në Ballkan, në katedralen e Shkodrës, kanë qenë mbajtur kongreset komuniste. Në një situatë të vështirë kërkova prej një personi në Kroaci që të lutet, ma ktheu se e kishte parë në vizion një qytet me fabrika, i thashë se ishte e vërtetë, por të gjitha ishin në kolaps. Ma ktheu përsëri se i kishte parë të reja... Ky vizion m'i hapi horizontet në lutje dhe kur erdha në shenjtëroren e Laçit, i thashë popullit: „Është turp të kërkohen prej Zotit gjëra të vogla, le të kërkohet gjëra të mëdha. A mund ta shohim në Shqipërinë tonë të ringjallur me autorrugë të reja, me fabrika të reja, me struktura të ripërtërira, me kisha dhe kuvende të reja.“

Kur kaloj sot nëpër Shqipëri dhe shoh se çka ka ndodhur, nga thellësia e zemrës lavdëroj Zotin, i cili e ngrit popullin e vet. Zoti ynë është i gjithëfuqishëm! Le ta lavdërojmë – Aleluia!

Ja në vazhdim profecia që u tha në kishën e shën Pjetrit në Romë të hënën e rrëshajave më 1975, në takimin ndërkombëtar të karizmatikëve me papën Palin VI.

Përkthyer nga shiriti i manjeto fonit... Publikoi Herbert Miilen... Gotten dinst 13/75...

#### Profeci

Unë të forcoj me forcën time  
Unë dëshiroj të përtërij Kishën time.  
Unë dëshiroj t'i prij popullit tim drejt bashkimit të ri!  
Unë kërkoh nga ti:  
Largohu nga kënaqësitë e panevojshme.  
Ki kohë për mua!  
Unë dëshiroj të ju përtërij nga themeli  
Shikoni brenda meje!  
Unë jam ende i pranishëm në Kishën time...  
Thirrja e re shkon drejt jush!  
Unë i ngrit vetes dëshmitarë  
I prij popullit tim drejt bashkimit  
Fuqia ime është në Të (papën)  
Ata do të shkojnë pas bariut tim të zgjedhur!  
Mos u largo prej meje!  
Më lejo që të mbush me Shpirtin Shenjt!  
Provo jetën time, Shpirtin tim të Shenjtë, fuqinë time!

Unë dëshiroj ta liroj botën!  
Së pari kam filluar ta përtërij Kishën time.  
Unë dëshiroj ta çoj botën drejt lirisë!“

Dëshiroj ta falënderoj Zotin e dashur dhe të gjithë ata që kanë punuar në këtë libër e sidomos zonjën Kata me prejardhje nga Bosnja që jeton në Lugano (Zvicër), e cila e ka sponsorizuar librin.

Mbushullim të bekimeve të Zotit u dëshiroj të gjithë atyre që do ta marrin në dorë këtë libër. Ky libër nuk shitet, por shpërndahet falas.

motra Svjetlana Rezo

## ***Kapitulli i parë***

### **Si të përjetohet dhurata e profecisë?**

#### **- metoda e punëtorisë**

“Populli im, sot po lëshoj mbi ju fuqinë e Shpirtit tim. Ashtu si shiu ujit tokën e thatë, ashtu Shpirti im ujit zemrat tuaja. Jini zemërhapur që të ju mësoj. Jini zemër hapur që të ju prij. Dijeni se sot po ju prek Shpirti im. Dijeni se zemrat e thyera do të përtërihen, se do të zhduken armiqësitë dhe do të shëroheni. Sot hapuni për mua. Pranoni nga Shpirti im. Mbushuni me dashurinë time.”

(Kjo profeci është pranuar në një bashkësi lutjeje gjatë një punëtorie mbi dhuratën e profecisë në San Antonio, shteti Texas.)

Zoti është dashuri...(1 Gjn. 4,16)

Fjala e Zotit na drejtohet aq shpesh: Zoti është dashuri. Ati është dashuri; Biri është dashuri; Shpirti Shenjt është dashuri. Viteve të fundit shumica e ligjëratave të mia fillojnë me këtë citat, sepse për ne njerëzit është shumë me rëndësi që gjithmonë dhe përsëri të dëgjojmë se Zoti është dashuri dhe si Ati dëshiron t’u japë aq shumë fëmijëve të tij të dashur; shumë më tepër se sa ne shpresojmë, se sa kërkojmë ose mendojmë. Kur në bashkësitë e lutjes lutemi për dhuratën e profecisë, ne kërkojmë që ajo dhuratë të lirohet në të gjithë të pranishmit. Besojmë se do të pranojmë atë që kërkojmë, sepse Zoti Atë është plot dashuri.

Për ata që nuk janë të informuar për metodën e punëtorisë mbi dhuratën e profecisë ose të cilët kurrë nuk kanë marrë pjesë në ndonjë punëtori për pranimin e dhuratave të Shpirtit Shenjt (1 Kor. 12,4-10), do të shpjegoj shkurtimisht se si i fusim besimtarët në atë përvojë:

1. I mësojmë mbi vetë dhuratën e profecisë;
2. Secili individualisht lutet që të pranojë dhuratën e profecisë;
3. Lutemi mbi secilin person të pranishëm që dhurata të bëhet e dukshme;
4. Tubohemi së bashku në rreth. Lutemi në gjuhë. Pastaj pushojmë dhe dëgjojmë;
5. Lirohemi dhe i themi fjalët profetizuese ashtu si i dëgjojmë;
6. Në fjalët e pranuarra përgjigjemi me lutje (falënderimi).

Kur në lutje bashkohemi në rreth, krijohet situatë e përshtatshme e lutjes, ku njeriu shumë lehtë hapet për dhuratën e profecisë, për derisa në rastet tjera, p. sh. në takimet e zakonshme të lutjes, ndoshta nuk ndjehemi aq të lirë ta themi atë që Zoti na ka dhënë dhe që dëshiron nëpërmes nesh ta thotë. Duket se në takimet e lutjes dhe në të tjera takime, njerëzit janë të mbyllur për shkak të ndjenjës personale të inferioritetit e nga frika, kështu që nuk janë në gjendje të flasin, dhe rasti kalon derisa të mposhten gjendjet e përmendura ndijesore.

Në këto të ashtuquajtura punëtori të dhuratës së profecisë, qëllimi është që secili të futet në dhuratën e profecisë duke krijuar gjendje lirie të mbushur me dashuri, ku njerëzit do të ndjejnë dashurinë dhe mbështetjen e të tjerëve, dhe kështu rezistenca në nivelin emocional nuk do të jetë aq e madhe. Kur bashkohemi, duam që Shpirti i Zotit të rrjedh nëpër ne me lehtësi të madhe. “Sepse ku janë dy ose tre vetë të bashkuar në emër tim, aty jam edhe unë mes tyre.”

Kam shpresë se ky libër do të ju afrojë dhuratën e profecisë deri në atë masë, sa që ajo vërtet të gjallërohet në jetën tuaj. Njëherë, kur isha në Angli, mu afrua pas punëtorisë një mjeke dhe më tha: “Problemi juaj qëndron në faktin se i thjeshtoni shumë gjërat.” U përgjigja: “Pse, çfarë ka ndodhur?” Ajo tha: “Po ja, madje edhe unë profetizova diçka gjatë punëtorisë.” Tani ajo udhëton përgjatë Anglisë dhe mban të njëjtat punëtori, të cilat në fillim i quante shumë të thjeshta. Po edhe dhurata e gjuhëve është e thjeshtë! Kungimi Shenjt është, po ashtu, i thjeshtë, është buka dhe vera që i bekon pushteti i meshtarisë, dhe bëhen Trupi i Krishtit. Kjo është aq e thjeshtë, sa që njerëzit nuk janë në gjendje që të kuptojnë. Edhe rrëfimi i mëkateve është punë e thjeshtë: “Më beko Atë, se mëkatova.” Zoti i ka dhuruar meshtarit pjesë në meshtarinë e Jezusit kështu që ai në emër të Jezusit i fal mëkatet. Gati të gjitha gjërat shpirtërore janë krejtësisht të thjeshta nëse mendojmë pak më me kujdes.

Në kapitullin e dymbëdhjetë të letrës së parë Korintasve lexojmë për nëntë dhuratat themelore shpirtërore: fjala e urtisë, fjala e dijes, feja, dhurata e shërimeve, dhurata e mrekullive, profecia, aftësia e dallimit të shpirtave, gjuhët e ndryshme, shtjellimi i gjuhëve. Me rastin e pagëzimit në Shpirt, Shpirti Shenjt mund të zgjojë në ne, fuqishëm, dhuratat e pranuar në pagëzim dhe krezmim! Por jo vetëm kaq! Të gjitha dhuratat e përmendura bëhen aktive në ne. Shumë teologë nuk pajtohen me këtë mësim (që dhuratat janë vepruese të të gjithë), por përvoja ime pesëmbëdhjetëvjeçare e vërteton pikërisht këtë!

Kur kemi qenë në Venezuelë, në punëtoritë tona të dhuratës së gjuhëve dhe të profecisë, kanë marrë pjesë afërsisht 500 deri 600 vetë. Shumica prej tyre e ka përjetuar përvojën e këtyre dhuratave, pikërisht duke iu falënderuar metodës së punëtorisë! Çka mund të përfundojmë, pra? Kur të pranosh pagëzimin në Shpirtin Shenjt, ato nëntë dhuratat e Shpirtit Shenjt bëhen vepruese të ti, por që ato të bëhen aktive, ti duhet të hapesh për to. Të gjithë ata që luten në gjuhë, kanë përvojën se, në një çast, në një mënyrë, janë hapur për atë dhuratë. Kur je pagëzuar në Shpirt, dhurata e gjuhëve ka lulëzuar te ti, por është dashur që të hapesh. Nëse nuk e ke lëvizur gojën, nuk je lutur në gjuhë, edhe pse ajo dhuratë në ty ka qenë aktive. E njëjta vlen edhe për profecinë. Ajo dhuratë është brenda teje, por duhet të bashkëpunosh me Shpirtin Shenjt dhe të hapesh për të. Ne vetëm të nxisim ta lirosh atë që është brenda teje dhe që ta shijosh dhuratën e Zotit. Të garantoj se do të mësosh të shërbehesh me dhuratën e profecisë, sepse Zotëria dëshiron më shumë se ti vetë që kjo dhuratë të bëhet efikase për ty. Nëpërmes dhuratës së profecisë e ndërton trupin e tij dhe i ndihmoni popullit të tij. *“Kurse, ai që profetizon u flet njerëzve: edukon, qorton, ngushëllon.”* (1 Kor.14,3)

Me dhuratën e profecisë vërtet e bën punën e Zotit! Ndoshta do të mund të mendosh se si ajo dhuratë mund të meritohet, se do ta fitosh kur të bëhesh i krishterë i mirë. Nuk është e vërtetë! Zotëria do që të bashkëpunosh me të! Të lutem, hapu, sepse rreth teje janë njerëzit, të cilëve ju duhesh. Zotëria dëshiron që ti të hapesh për dhuratat e Shpirtit të tij më

shumë se ti vetë që dëshiron. Dhuratat janë të drejtuara, gjithmonë, që t'i bëjmë veprat e tij, dhe jo veprat tona, vetëm se ne kemi prirjen që çdo gjë ta shohim mbrapsht!

Në bashkësinë e Atë Rick Tomas-it në El Paso i kushtohet rëndësi e madhe dhuratës së profecisë. Kanë ndodhur ngjarje të mrekullueshme pasi që bashkësia ka vepruar në harmoni me profecitë e pranuar. E tërë bashkësia ka përparuar, pikërisht pse disa pjesëtarë të bashkësisë i kanë përcjellë besnikërisht fjalët profetike. E tërë ajo krahinë ka qenë e bekuar begatshëm nëpërmes të asaj bashkësie. Po, Zotëria dëshiron që t'i kemi dhuratat, madje më shumë se sa ne vetë dëshirojmë.

Nganjëherë për dhuratat mendojmë si për medaljet. Nëse jemi të mirë, do të fitojmë medalje – dhuratën e gjuhëve ose dhuratën e profecisë - si dhuratë. Megjithatë, puna nuk qëndron kështu. Kjo nuk është e vërtetë. Zotëria dëshiron që të jeni dritë e fortë dhe dinamike atje ku jetoni, në shtetin tuaj, në qytetin tuaj. Duhet të jeni dritë që të mund të bëni veprat e tij. Nuk mund të jesh mjet i Shpirtit Shenjt e të mos kesh bekimin, sikurse që nuk mund të luash me zjarr e të mos digjesh. Dhe bekimet do të vijnë në jetën tënde vetëm kur të bësh veprat e tij. Do të jesh vërtet i bekuar, kur t'i hapesh dhuratave të tij, por mos i prit dhuratat si medalje, për veprat e mira.

Pjesa më e vështirë e rrugës prej 1000 km është hapi i parë. Pjesa më e vështirë e profecisë është fjala e parë. Sugjerimi ynë është: “Jepi Zotërisë atë që ai të ka dhënë ty. Jepi atë që ke.”

Si ndodh profecia! Profecia vjen në fjalë, fotografi dhe këngë. Nëse vjen si këngë, këngën duhet kënduar, nëse vjen si fotografi, mund të themi: “Kam vizion. Shoh se si Jezusi po i prek të gjithë të pranishmit në këtë kthinë.” Po ashtu, vizionin mund ta përshkruajmë. Me vizion mund të pranosh edhe profecinë: “Shoh Jezusin dhe ai thotë: ‘Populli im, hapuni për dhuratat e mia. Hapuni për Shpirtin tim.’ Profecia mund të vijë në një varg mënyrash të ndryshme, për çka do të bëhet fjalë më vonë. Jepi, pra, atë që Zotëria të ka dhënë. Mos hezito nëse Zotëria pret që të shërbehet me ty. Ai dëshiron ta bindë secilin në dashurinë e tij nëpërmes fjalës që do ta thotë pikërisht nëpërmes teje.

Pas ligjëratës së parë mbi profecinë në punëtori, zakonisht i lusim një grup njerëzish, të cilët qëndrojnë në rreth që t'i mbyllin sytë dhe të këndojnë në gjuhë, pastaj i lusim që të jenë të qetë dhe të dëgjojnë. Pasi që ndonjë person dëgjon dy-tri fjalë në zemrën e vet, do ta pyes veten se a vjen ajo prej tij apo prej Zotërisë. Sa herë që ia bëni vetes këtë pyetje, mund të supozoni se është prej Zotërisë, sepse kjo nuk është pyetje e zakonshme, të cilën ia bëni vetes në shtëpinë tuaj. Kur është fjala për përditshmërinë, e dini mirë se jeni ju. Sa herë që dyshoni, mund të supozoni se është Zotëria, sepse ai vepron pikërisht ashtu: qetë dhe butë. Për mua, vetë dyshimi është argument i mjaftueshëm se diçka vjen nga Zotëria. Pasi jemi lutur për dhuratën e profecisë dhe pasi meshtari është lutur për ne, që dhurata, për të cilën është fjala, të lirohet brenda nesh, duhet vetëm të besojmë, se do ta marrim atë që kemi kërkuar. “Lypni e do t'ju jepet, kërkoni dhe do të gjeni, trokitni e do të ju çelet! Sepse, kush lyp, i jepet, kush kërkon, gjen e kush trokëllit, i çelet. Dhe, a gjendet njëri ndër ju që, po i lypni i biri bukë, i jep gurë? ose, po i lypni peshk, i jep gjarpër? Po qe, pra, se ju që jeni të këqij, dini t'u jepni gjëra të mira bijve tuaj, aq më tepër Ati juaj që është në qiell, do t'u japë gjëra të mira atyre që ia lypin. (Mk 7, 7-11)

Jo rrallë gjatë punëtorisë Zotëria na dhuron shugurim, ndjenjën e pranisë së tij. Ngrohtësia, dridhja, apo ndjenja e rrymës ose peshës në duar, janë përjetim ndijesor i pranisë së Zotërisë. Mund të ndjesh vetëm paqe të thellë. Zotëria do të të thotë me këtë: “Unë jam. Mos ke frikë, por fol!” Atëherë i thua fjalët ashtu si i ndien në zemrën tënde.

Në një situatë të sigurt, çfarë është kjo, mund të gabosh vetëm nëse nuk flet. Gjithmonë do të ketë shumë të atillë që mendojnë kështu: “Jo, unë jo. Unë nuk e kam dhuratën e profecisë.” Pas njëzet minutash do të thotë: “Nuk jam i sigurt. Në fillim e dija se çka duhet të them, por nuk isha i sigurt.” Kur të mendojmë pak më mirë në lidhje me këtë, a nuk na kanë munduar të njëjtat dyshime, edhe kur e kemi pranuar dhuratën e gjuhëve?

Pasi që Shpirti Shenjt vepron aty ku mbretëron ndjenja e thellë e bashkësisë, të përpiqemi të krijojmë aso gjendje. Si të arrihet kjo në grupin e njerëzve, ku disa njihen mes veti kurse disa jo? E kam zbuluar se është i dobishëm qëndrimi në rreth me dorë në krah të personit afër nesh. Bashkësia, ndjenja e bashkësisë, ndërtohet më së miri me prekje. Prekja e njerëzve është njëra prej formave më të larta të besimit. Kur të formojmë rrethin dhe të qëndrojmë afër njëri-tjetrit, dhe të vëmë dorën njëri në tjetrin, krijojmë ndjenjën e besimit që ndërton themelin e bashkësisë. Do të ndjeheni një në Shpirt; një në dashuri, e atëherë Zotëria mund të veprojë dhe do të veprojë me siguri, sepse jemi bashkuar në lutje.

Qëndrimi në rreth dhe lutja në gjuhë bën që t'i hapeni Shpirtit Shenjt dhe dhuratave të tij. Mbyllni sytë, ndaluni dhe dëgjoni. Thoni fjalët ose fjalën që dëgjoni në zemrën tuaj, në vetën e parë ose të dytë. Kur një person profetizon, atëherë del prej rrethit dhe vazhdon të lutet për ata që kanë mbetur në rreth. Rrethi zvogëlohet vazhdimisht derisa të gjithë profetizojnë. Nëse mbesin një ose dy persona, të cilët nuk e kanë zhvilluar këtë dhuratë, le t'i marrë dikush e t'i dërgojë në një vend tjetër që të mos ndihen keq duke mbetur të fundit.

Kur organizojmë punëtori të tilla, i përcjellim të gjithë pjesëmarrësit, në mënyrë që ata nuk ndjehen vetëm, si në takimin e lutjes. Dëshirojmë t'ua lehtësojmë sa më shumë që është e mundur këtë përvojë të re. I nxisim dhe lutemi për ta. Bëjmë çdo gjë që mundemi, dhe ata duhet vetëm të hapen dhe pastaj të flasin.

Ja edhe një herë pasqyra e shkurtë:

Mbani një ligjëratë të shkurtë mbi dhuratën e profecisë.

Secili le të lutet në vete për dhuratën e profecisë.

Lutemi që kjo dhuratë, e cila është brenda nesh, prej pagëzimit me Shpirtin Shenjt, tani të lirohet. Dëgjoni Shpirtin Shenjt që është brenda jush.

Duke qëndruar në rreth, me dorën në krahun e personit afër nesh, lutemi në gjuhë. Ndalem. Dëgjojmë.

Hapemi dhe themi fjalën që dëgjojmë, në vetën e parë ose të dytë. Ndoshta ndjejmë shugurim të veçantë.

Ai që profetizon del prej rrethit dhe lutet për ata që janë në të.

Duke dëgjuar profecitë e të tjerëve, ti edhe vetë pranon profeci dhe do të duhej që në ato fjalë të përgjigjesh. Për shembull, nëse dikush thotë: Ju ftoj që sot në mënyrë të veçantë të vetëdijesoheni për dhuratat që kam për ju dhe të cilat dua t'ua jap. Hapuni, fëmijët e mi, pranoni sot këto dhurata dhe mbani në mend se gjithmonë jam me ju." Në ato fjalë mund t'i përgjigjemi vetes kështu: " Të falem nderit Zotëri, që na thërret sot, se ke dhurata për ne. Na ndihmo që me mendje dhe zemër të hapur të pranojmë çdo gjë që ke për ne. Na ndihmo që të mbajmë në mend se je gjithmonë me ne."

## ***Kapitulli i dytë***

### **Profecia – dhuratë për të gjithë**

Populli im, dije se të dua. Dije se të kam thirrë me emër. Dije se dëshiroj të të mbush me të gjitha dhuratat e Shpirtit tim të Shenjtë. Hapu për mua dhe unë do të të mbush, do të mësoj që të kesh mundësi të ecësh në emër tim, në lavdinë time, që ta shërosh botën time të plagosur. Populli im, dije se kënaqem për secilin prej jush.

(Profeci e thënë në një nga punëtoritë e dhuratës së profecisë.)

*Kërkoni të fitoni dashurinë. Dëshironi edhe dhuratat e Shpirtit Shenjt, sidomos atë të profecisë. (1 Kor 14,1)*



Në fillim të bëjmë këtë pyetje: çka është dashuria? Përgjigja ime do të ishte se profecia është parathënie e mendimit të Zotit. Zotëria sot dëshiron të na flasë dhe ai sot do ta bëjë këtë. Ai dëshiron që secilit veç e veç t'ia përcjellim dashurinë e tij, si dhe planin e veçantë që ka për secilin prej nesh. Nuk duhet të na çuditë madhësia e dashurisë së Atit. Na i ka dhënë të gjitha - Birin e vet, Shpirtin Shenjt, mbarë Kishën, sakramentet. Nëse e lusim, sigurisht do të na e zbulojë edhe vullnetin e tij për jetën tonë. *“Hyji na e zbulon këtë vërtet me anë të Shpirtit Shenjt: sepse Shpirti Shenjt depërton të gjitha, edhe vetë thellësinë e natyrës hyjnore.”* (I kor 2,10)

Profecia është gjithsesi dhuratë e Shpirtit Shenjt me të cilën zbulohet qëllimi i Zotit, thellësitë e Zotit, tani dhe këtu. Kjo është profecia dhe ajo u është dedikuar të gjithëve.

Lirisht mund të themi se të gjithë njerëzit në njëfarë mënyre e “nënçmojnë” dashurinë e Atit. Shën Pali thotë: *“Kurse ai që profetizon u flet njerëzve: edukon, qorton, ngushëllon. Ai që flet gjuhë të huaj, edukon veten, kurse ai që profetizon, edukon bashkësinë. Dëshiroj që të gjithë të flisni në gjuhë të ndryshme, por më tepër dëshiroj të profetizoni.”* (1 Kor 14, 3-5) Kjo është interesante! Të profetizosh do të thotë të kesh mendimin e Zotit e jo domosdoshmërisht të profetizosh të ardhmen. Profecia nganjëherë mund të na zbulojë diçka nga e ardhmja, por më së shpeshti kemi të bëjmë me atë që Zotëria dëshiron t'i thotë popullit të vet atë çast. Përvoja e profecisë në jetën e të krishterit është krejtësisht e natyrshme, dhe gjithsesi është nxitje dhe rrugë drejt shenjtërisë. Shën Pali thotë: *“Kërkoni të fitoni dashurinë. “Dëshironi edhe dhuratat e Shpirtit Shenjt, sidomos atë të profecisë.”* (1 Kor 14, 1) Profecia shërben për ndërtimin e Kishës (1 Kor 14, 4) është e nevojshme për ndërtimin e trupit të Krishtit, e ju jeni gjymtyrët e trupit të Krishtit (1 Kor 14, 1) Shën Pali më tej thotë: *“Dëshironi(...) dhuratat e Shpirtit.”* Ato janë të dedikuara për ju, Trupin e Krishtit, e gjithashtu dëshironi dhuratën e profecisë, (1 Kor 14, 39) për ndërtimin e Kishës. Disa kanë prirjen të thonë se nuk mund të kërkojnë dhuratat shpirtërore, sidomos profecinë, sepse dhuratat “janë për njerëz të shenjtë.” Duhet të jemi shumë të kujdesshëm këtu që të mos i barazojmë dhuratat e Shpirtit Shenjt me shenjtërinë. Dhuratat e Shpirtit Shenjt sigurisht mund të jenë rrugë drejt shenjtërisë, por nuk është domosdoshmërisht ashtu. Gjithashtu, edhe mua meshtaria mund të më çojë në shenjtëri, por jo gjithsesi. Mund të them kështu: *“Do të jem meshtar, por do të jetoj jetën time.”* Unë edhe më tutje kryej meshtarinë time, ashtu si ju shërbehëni me dhuratën e profecisë, por nuk më duhet të jem i shenjtë që të jem meshtar, ashtu si edhe ju nuk është e domosdoshme që të jeni të shenjtë që të profetizoni. Profecia vetëm çon ose mund të çojë te shenjtëria.

Profecia është fjalë e Zotit që e dëgjojmë në zemrën tonë, fjalë që Zoti do të na e thotë – jo në kokë, por në zemër. Nganjëherë nuk është lehtë të hyhet në atë përvojë, sidomos për ne meshtarët, do të mund të thuhej edhe për të gjithë meshkujt në përgjithësi, sepse tërë jetën na kanë mësuar që të “mendojmë me kokën tonë”! Vërtet, shpesh kemi prirjen që të “mendojmë dhe të filozofojmë.”

Por tani është koha që të mendojmë me zemër! Dëgjoni fjalët që i ndjeni në zemër dhe thoni ato, sado që të duken të rëndomta. Profecitë gjithmonë vijnë në vetën e parë ose të dytë, si p.sh: *“Të dua, populli im. Ti je grigja ime.”* Po të profetizonim në vetën e tretë, nuk do të përcillnim mendimin e Zotit. Zotëria është person që na drejtohet në vetën e parë ose të dytë në mënyrë të drejtpërdrejtë; ajo është fjala që do ta ndjeni në zemër.

Kur të pagëzohemi në Shpirtin Shenjt, shpirti ynë i dorëzohet krejtësisht Shpirtit Shenjt, është sikurse kurorëzimi ynë shpirtëror me Shpirtin Shenjt. Pagëzimi në Shpirtin Shenjt është dorëzimi ynë i plotë Zotërisë. Kjo është vërtet kurorëzim shpirtëror. Kur kurorëzohen dy vetë, vijnë para altarit dhe me rastin e ceremonisë thonë një fjali shumë të rëndësishme: *“Po të marr ty (...) për burrin (gruan) time.”* Ato fjalë ndërrojnë rrjedhën e jetës së tyre. Pas atyre fjalëve ata kurrë më nuk do të jenë të njëjtë. Është ngjashëm edhe me pagëzimin në Shpirtin Shenjt. Në atë çast hiri i Zotit fillon të veprojë në jetën tonë dhe mund të themi: *“Zotëri, po ta dorëzohet shpirtin tim. Po ta dorëzohet zemrën time. Zotëri, po të bie në*

dorë.” Jeta jonë kurrë më nuk do të jetë e njëjtë. I dorëzohemi në dorë Zotërisë e Ai na jepet neve në një mënyrë krejt të re – ky është kurorëzimi shpirtëror. Kur kemi filluar të lutemi në gjuhë, zërin tonë ia kemi dhuruar Zotërisë: “Zotëri, po t’i dorëzohet aftësitë e zërit. Do të bëhem palaçoja yt.” *Sepse ai që flet në gjuhë të huaj, flet me Hyun e jo me njerëz: askush nuk e merr vesh, sepse me anë të Shpirtit flet sende të fshehura.*” (1 Kor 14,2)

Deri tani kemi parë se si, kur e pranojmë pagëzimin në Shpirtin Shenjt, ia dorëzojmë jetën tonë Zotërisë; pastaj kur flasim në gjuhë, Zotërisë ia dorëzojmë zërin tonë. Në profeci shkojmë një hap më tej dhe Zotërisë ia dorëzojmë mendjen tonë, asisoj, që Ai nëpërmes nesh t’i thotë mendimet e veta. “Zotëri, po ta dorëzohet mendjen time. Do t’i them fjalët tua ashtu si i ndjej në zemrën time.” Pasi që Zotërisë ia kemi dorëzuar mendjen tonë, i themi fjalët e tij.

Ashtu sikurse kam thënë më parë, ne rrallë herë flasim diçka që më parë nuk e kemi menduar. Tani duhet që ta kthejmë mbrapsht këtë proces, duke mos menduar se çka do të themi. Kur e ndjeni praninë e Zotit, ndoshta njëra prej dy fjalëve do të përsëritet vazhdimisht. Nëse pranoni disa fjalë, ajo është profeci. Nuk është e thënë që të gjitha të kenë kuptim logjik, që të jenë të njohura të gjitha arsyet. Në të vërtetë, dëshiroj t’ju them që ta shkyçni mendjen dhe të thelloheni në zemër. Le të jetë koka juaj atje ku është zemra. E kur t’i dëgjoni ato fjalë që Jezusi ua ka vënë në zemër (e ai do ta bëjë këtë, nëse vetëm e lutni), atëherë thoni thjesht. Profecia është njëra prej mënyrave, me të cilën Zoti ka vendosur të shërbehet që t’i flasë popullit të vet. Në këtë mënyrë komunikon me njerëzit që nga fillimi i botës. Në të njëjtën mënyrë Zotëria dëshiron të komunikojë me ju dhe me bashkësinë tuaj të lutjes. Dëshiron të komunikojë me besimtarët e tubuar, sepse në vetë natyrën e dashurisë është që të përcillet, gjegjësisht të komunikojë. Provoni p.sh. djaloshtit dhe vajzës që janë të dashuruar në njëri-tjetrin, t’ia ndaloni bisedën. Kjo do të ishte për ta e padurueshme. Është e njohur, po ashtu, se bashkëshortët e moshuar jo rrallë vdesin shumë shpejt njëri pas tjetrit. Ata më nuk mund të komunikojnë, nuk mund të ndajnë dashurinë e tyre, dhe kjo ua merr jetën. Pasi që është vetë natyra e dashurisë që të përcillet, që të komunikohet, njëri nga ata vdes kur nuk e ka atë me të cilin do të mund të ndajë dashurinë. Zotëria dëshiron të na flasë, sepse Ai është dashuri: dëshiron t’i flasë secilit një për një, si dhe bashkësisë.

Një herë kam shuguruar 125 rregulltare dhe gati secila prej tyre ka pranuar profeci personale. Zotëria ka dëshiruar që t’i flasë secilës prej tyre, ashtu si dëshiron t’i flasë secilit prej nesh. Dëshiron t’i flasë bashkësisë suaj. Në takimin e lutjes, kur ndodh dialogu në mes jush dhe Zotërisë, kur Ai ju flet nëpërmes të profecisë, kjo do të ndodhë në thellësinë e zemrës suaj, nëpërmes Shkrimit Shenjt, me fjalët e vëllezërve dhe motrave tuaja. Zoti dëshiron t’i flasë popullit të vet.

*Samueli u përgjigj: “Fol, shërbëtori yt dëgjon.”*

(1 Sam 3,10)

## **Takimet e lutjes, lavdërimi dhe dhurata e profecisë**

Çka është takimi i lutjes? Ai është tubimi i Trupit, Kishës, që të hyhet në dialog me Atin. Atit i drejtohem me lavdërim dhe lutjen në gjuhë të ndryshme, kurse Ai na flet nëpërmes dhuratës së profecisë. Është fjala, d.m.th., për dialog. Në fakt, tubohemi që të lutemi. Çka është lutja? Lutja është bisedë (dialog) me Zotin. A keni parë ndonjëherë gruan se si bisedon në telefon dhe njëkohësisht hekuros rrobat? Ky është dialog. Marrje e dhënie. Kur është fjala për tinxherët, ata shpesh bisedojnë në telefon me shokët, për derisa janë të shtrirë përmbys në krevat me këmbë të ngritura në ajër. Ky është dialog. Njerëzit afaristë kalojnë nga dy-tri orë në punë duke bërë biseda afariste. Kemi të bëjmë me këmbimin e

ideve, idealeve dhe ndjenjave. Në këtë kuptim, takimi i lutjes është në thelb dialog në mes nesh e Zotërisë..

Dialogu nënkupton që të shkojmë te Zotëria dhe t'i drejtohem. Tubohemi dhe hyjmë në dialog si bashkësi. Kur lutemi së bashku, lirohet një fuqi e mrekullueshme për të cilën shpesh nuk jemi të vetëdijshëm. Ne shkojmë te Zotëria në lutje, lavdërim, madhërim dhe falënderim, kurse Ai vjen tek ne. Forca dhe prania e tij paraqiten kur bashkësia hyn në dialog me të, në mënyrë të veçantë nëpërmes dhuratave të Shpirtit Shenjt, e sidomos, aq fuqishëm, kur lutemi në gjuhë. Do të ishte mirë që të gjithë anëtarët e bashkësisë së lutjes, të luten në gjuhë. Të gjithë atyre që nuk e kanë atë përvojë, ju sugjeroj librin tim *Dhurata e gjuhëve*, sepse, sikurse kam shpjeguar, pohoj, dhuratat e Shpirtit janë brenda qenies suaj, sepse jeni të pagëzuar në Shpirtin Shenjt, dhe fillojnë të veprojnë kur të hapeni për to. Në të njëjtën mënyrë, secilit prej nesh i është dhënë dhurata e profecisë, vetëm se duhet të çelemi dhe ta shijojmë. Sa më shumë që në bashkësitë tona janë të pranishme lavdërimi, këndimi, madhërimi dhe falënderimi, dhuratat e Shpirtit Shenjt lirohen dhe rrjedhin më lehtë.

Udhëheqësit e bashkësive të lutjeve duhet t'i ndihmojnë secilit që të çelet për dhuratat. Do të duhej që anëtarët e bashkësive të jenë të vetëdijshëm për pengesat në të cilat do të ndeshen dhe atyre do kushtuar aq kohë sa edhe mësimi për gjërat që do t'u ndihmojnë të hapen. Me duket, problemi më i madh në mes nesh qëndron në faktin se njerëzit nuk nxiten në dhurata. Me të vërtetë, të gjithë neve duhet nxitur që të shërbehemi me dhurata lirisht dhe hapur, sidomos kur është fjala për dhuratat e gjuhëve dhe të profecisë. Ja një shembull i mirë nga libri *Dhuratat e fjalës*: "...takimet tona të lutjes ishin të thata. Ishin bërë formale dhe kishin humbur freskinë. Pas disa muajsh të 'hulumtimit të shpirtit' nga ana e udhëheqësit u pa se cila është arsyeja për këtë: nuk e kishim përvojën e dhuratës së fjalës. Madje as që e kemi kërkuar. Dukej se faji qëndronte te ne për shkak të shmangies nga dhurata e profecisë, shmangies nga fjala e urtisë dhe e njohjes. Nuk e kishim përvojën e shtjellimit të gjuhëve, dhuratën e urtës së frymëzuar, si dhe porosive të tjera verbale nga Zotëria.

Pasi që kisha autoritetin, e kisha për detyrë që ta lus Zotërinë që këto dhurata t'i derdh mbi bashkësinë tonë të lutjes. E kërkoja Zotërinë e Ai më dëgjoi. Porosia e tij që më drejtohej mua ishte e drejtpërdrejtë dhe e thjeshtë: Studioji dhuratat që të mësosh se çka janë dhe mëso që të shërbehesh me to e pastaj mësoji edhe të tjerët. Ashtu edhe bëra. I studiova dhuratat, mësova që të shërbehem me to dhe i mësova të tjerët për atë që kisha mësuar. Kam lexuar shumë dhe jam këshilluar me besimtarë me përvojë. Të gjitha që i zbuloja dhe i përvetësoja, ua përcillja bashkëpunëtorëve të mi më të afërt, e pastaj edhe të gjithë pjesëtarëve të bashkësisë së lutjes.

Bekimet kanë qenë të shumta dhe të dukshme: rritja shpirtërore, si dhe rritja e numrit të anëtarëve. Fuqishëm iu afruam Zotërisë si edhe njëri-tjetrit. Dhe ne u bëmë ungjillëzues. Brenda disa muajsh numri i anëtarëve të bashkësisë sonë u bë gati njëqind, nga njëzet sa i kishte më parë.

Besoj se, sikur të mos kishim mësuar që të shërbehemi me dhuratat e fjalës së Shpirtit të Shenjtë, bashkësia jonë e lutjes do të zvogëlohej dhe më në fund do të fikej krejtësisht. Por pasi që jemi përgjigjur në nxitjen e Shpirtit Shenjt, edhe shumë të tjerë përveç nesh e njohën, e deshën dhe vendosën që ta ndjekin Zotërinë tonë Jezu Krishtin." Edhe një shembull nga i njëjti libër: "Në vitin 1981 Atë Randall fillojë lëvizjen 'Kthimi në baza'. Edhe një herë i theksoi dhuratat shpirtërore, sidomos dhuratat e fjalës. Filloi të predikojë dhe të mësojë për dhuratat e Shpirtit Shenjt dhe t'i nxisë njerëzit të marrin pjesë në takimet e lutjes ku manifestoheshin dhuratat.

Rezultatet vërtet ishin mbresëlënëse. 'Në gusht të vitit 1982, në të vërtetë, nuk kishim bashkësi lutjeje – tregon Atë Randall. Deri në gusht të vitit 1983, më se treqind vetë na vinin në takimet javore të lutjeve, që të dëgjonin Fjalën e Zotit.' Ky vitalitet i ri shpirtëror i

ka nxitur shumë ndryshime të reja në famullinë e Atë Randallit. Njëra nga to është edhe shërbesa javore e shërimit, e cila tërheq me qindra njerëz në lavdërimin e Zotërisë dhe lutjen për shërim.

Shembujt e lartpërmendur vërtetojnë atë që po ndodh në shërbesën time, derisa udhëtoj në mbarë vendin dhe mbaj punëtori për dhuratat e Shpirtit. Ndërkaq, kjo neve na çon deri tek përvojat më të thella shpirtërore dhe deri tek vetë thelbi i gjërave: lavdërimin e Zotit, prej të cilit rrjedhin të gjitha bekimet tona (shërimi, bashkësia, falja, etj).

Këtu dëshiroj të shtoj disa fjalë për lavdërimin në takimet e lutjes. Lavdërimi i Zotërisë për shumicën e katolikëve paraqet vështirësi, sepse jemi të mësuar që Zotërisë t'i drejtojmë kërkesa, dhe jo aq shumë ta lavdërojmë. Në librin e tij mbi lutjen, Shën Alfonsi thotë se lutja më fisnike që dikush mund ta thotë, është lutja e kërkesës. Personalisht besoj se lutja më fisnike është lutja e LAVDËRIMIT!

Problemi i lutjes së kërkesave konsiston në faktin se NE jemi qendra e lutjes. Njerëzit e kanë të vështirë që për një kohë të gjatë të mbajnë qëndrimin e lavdërimit, sepse, natyrisht, dëshirojnë që të kthehen në drejtimin e kërkesave Zotërisë dhe paraqitjen e nevojave dhe problemeve të tyre. Mirëpo, nëse e lavdërojmë Zotërinë, nëse e lartësojmë më tepër, nëse përqendrohemi në të dhe dëshirojmë të bëjmë diçka për të, ashtu edhe Ai do të na ndihmojë neve. “E unë, kur të jem lartësuar nga toka, do t'i tërheq tek unë të gjithë njerëzit.” (Gjn 12,32)

Fshehtësia e marrjes qëndron në dhënie. “Jepni e do t’ju jepet: masë e mirë, e dendur, e tundur; me grumbull do t’ju jepet nën sqetull tuaj: sepse me atë masë që të matni, do t’ju matet edhe juve në kthim.” (Lk. 6,38)

Kjo është gjithsesi njëra prej fshehtësive më të thella të Mbretërisë së Hyjit. Si të marrim prej Zotërisë? JEPNI Zotërisë! (qoftë para, kohë, talent, lavdërim – jepni Zotërisë). Nëse dëshironi që takimet e lutjeve të jenë të bekuara, nëse dëshironi që ju të jeni të bekuar dhe të dëgjoni porosinë e tij për ju, kërkojeni nëpërmes të lavdërimit.

Në bashkësinë tonë, gjatë takimit të lutjes, nuk bëjmë kërkesa. Njerëzit i sjellin të shkruara kërkesat e tyre në copa letre, i vendosin në enë dhe i harrojnë. Ashtu si këndohet: “Le të harrojmë veten, të përqendrohemi në Të dhe ta lavdërojmë...” Sikur të lejonim lutjen e kërkesave, njerëzit do t’u ktheheshin shprehive të tyre të vjetra dhe nevojat e tyre do të ishin qendra e takimit të lutjes, dhe jo lavdërimi i Zotit. Takohemi si bashkësi që të lavdërojmë Zotin. Zotërisë i drejtohem me dhuratën e gjuhëve, kurse Ai neve na drejtohet me profeci dhe me dhuratën e Fjalës së shkruar. Me rastin e shtrirjes së duarve është e mundur që të zgjidhen probleme të veçanta të njerëzve, por qëllimi kryesor i takimit të lutjes është lavdërimi i Zotit.

Pasi që me vite takohem dhe punoj me bashkësitë e lutjeve, vërejtjen të cilën mund t’ua jap udhëheqësve të bashkësive të lutjeve, ka të bëjë me faktin se nuk e lavdërojnë Zotin sa duhet. Ky është shpesh shkaku i tendosjes në mes udhëheqësve, sepse kujdesin më të madh ua kushtojnë njerëzve, në vend që të përqendrohen në Zotërinë, në Jezusin, ata merren jashtë mase me autoritetin e tyre si udhëheqës. Ndoshta nuk jemi gjithmonë të vetëdijshëm për këtë gjë, por lavdërimi i Zotit është caku kryesor i takimit të lutjes. Ne nganjëherë, në takimet e lutjes, këndojmë në gjuhë më se pesëmbëdhjetë minuta. Kjo do të thotë të lavdërosh Zotin! Është një kishë jokatolike në përfundimin e mesëm, ku njerëzit këndojnë në gjuhë njëzet e pesë minuta. Ata njerëz dëshmojnë se kurrë nuk kanë parë aso mrekullish (përsëri është fjala për dhuratat e Shpirtit Shenjt në vepër) sikurse në ato takime ku dikush e lavdëron Zotin, një kohë aq të gjatë. Kur e lavdërojmë Zotin, mëshira e tij është në ne dhe mrekullitë ndodhin!

Para se të fillojmë me lavdërim, shpesh jemi të tendosur dhe të mbyllur, por kur lutja fillon, i çojmë duart lart dhe përqendrohemi në Të, dhe Shpirti Shenjt lirisht zbret pasi që jemi të hapur. Kjo më parë nuk ishte e mundur. Jo pse nuk ka dashur, por thjesht nuk ka mundur, sepse pengesat kanë qenë brenda nesh. Kur e lavdërojmë Zotin, hapemi për

pranimin e asaj që Shpirti Shenjt ka për ne dhe sigurisht do të na flasë nëse këtë e kërkojmë.

Në përgjithësi, lavdërimi nuk duhet sforcuar së tepërmi, ashtu si edhe lutja në gjuhë. (Në bashkësitë e mëdha të lutjeve, vitet e fundit është bërë e zakonshme duartrokitja, në vend të lutjes në gjuhë. Takimi i lutjes është rast shumë i mirë për lavdërimin e Zotit në gjuhë! Madje edhe në fund të lutjes, pas dëshmisë, është koha për lavdërimin e Zotit dhe jo për duartrokitje. Nëse duartrokasim do të mund të përqendroheshim përsëri në personin, e jo në Zotërinë.) *Këndej, me anë të tij t'i kushtojmë vazhdimisht Hyut fli lavdie, d.m.th. frytin e buzëve që dëshmojnë Emrin e tij.* (Heb 13,15)

“Hapeni tërë qenien tuaj dhuratave të mia të cilat dua t’ua jap” – këtë na flet Zotëria pikërisht tani, me ç’rast kërkon që vetëm të jemi të hapur.

Profecia është vepër e Zotit. “(...)nëse askurrë nuk ndodhi ndonjë profeci me vullnet të njeriut, por njerëzit të frymëzuar nga Shpirti Shenjt, folën nga ana e Hyut..” (2Pj 1,21)

Lavdërimi dhe lutja në gjuhë janë mënyra me të cilat në takimet e lutjes i drejtohem Zotërisë. Profecia, leximi i fjalëve të shuguruara të Shkrimi Shenjt, - janë mënyra me të cilat Ai na flet. Ky është “cikli karizmatik” i takimit të lutjes! Zotëria dëshiron të dëgjojë si e lavdërojmë dhe atëherë do të na flasë!

## **Kapitulli i tretë**

### **Udhëzime të rëndësishme**

“Populli im, ju jeni shërbëtorët e mi. Përcillni dritën, dashurinë time shëruese shumë njerëzve! Populli im, do ta shëroj secilin prej jush veçanërisht. Atje ku është dyshimi unë do ta zëvendësoj me besim. Atje ku është ankthi, do ta zëvendësoj me siguri dhe mbështetje. Do të bëj vepra të mëdha në secilin prej jush. Atëherë do të ecni në fuqinë time, më të fortë se kurdoherë më parë..”

*“...Eh, po të ishte e mundur që i tërë populli të profetizojë e Zoti t’ia jepte Shpirtin e vet!*

(Nr 11,29)

Në këtë pjesë të Besëlidhjes së vjetër Moisiu ka thënë diçka madhështore për profecinë. Më vonë, në Besëlidhjen e re, Shën Pali do të shtojë: *“Dëshiroj që të gjithë ju të flisni në gjuhë të ndryshme, por më tepër dëshiroj të profetizoni, sepse më i madh është ai që profetizon se ai që flet në gjuhë të ndryshme, përveç se në shtjelloftë për edukimin e Kishës.”* (1 Kor 14,5) Në Besëlidhjen e re, të gjithë kanë dhuratën e profecisë në Shpirtin Shenjt, nëse i hapet, ndërsa në Besëlidhjen e vjetër kjo ishte dëshira e Moisiut – që të gjithë të jenë profetë dhe të kenë mundësi të profetizojnë. Në bazë të këtyre teksteve të Shkrimit Shenjt, mund të jemi të sigurt se: është pjesë e planit të Zotit që t’u hapemi dhuratave shpirtërore të tij, e sidomos dhuratës së profecisë.

Ashtu si më tha dikush pak kohë më parë: “Zoti ynë është Zot personal, ka raport personal me secilin prej nesh. Në të vërtetë, këtë nuk e dimë aq mirë në zemrën tonë sikur se do të duhej ta dinim. Ai është shumë personal dhe besoj se çdo herë kur dëshironi t’i thoni diçka Zotit dhe të dëgjoni përgjigjen e tij, mjafton ta pyetni dhe nëse krejtësisht qetësoheni, do ta dëgjoni në veshin ose mendjen tuaj, ose thjesht do t’u vijnë fjalët nga brenda. Nëse keni besim që cilësohet me pritje dhe besoni se si Zoti personal do t’ju flasë nëpërmes profecisë – Ai do ta bëjë këtë. Nëse keni asi besimi që pret, duke e ditur se çfarë është Zoti ynë, sigurisht nuk do t’ju tradhtojë.

Mos harroni se Zoti është DASHURI. Ati është dashuri. Biri është dashuri. Shpirti Shenjt është dashuri. Ata dëshirojnë të na dhurojnë më shumë se sa do të mund të mendojmë, dëshirojmë ose kërkojmë.

Ja disa udhëzime të cilat do të mund t'ju ndihmonin që t'i hapeni dhuratës së profecisë dhe ta shijoni në jetën tuaj. Ashtu si i lexoni, studioni dhe përdorni udhëzimet e dhëna, ato do ta forcojnë dhuratën tuaj të profecisë për ndërtimin, trimërimin dhe ngushëllimin e të afërmeve, anëtarëve të familjes, bashkësisë së lutjes si dhe për ata për të cilët luteni.. *"...pasi dëshironi me gjithë zemër t'i keni dhuratat e Shpirtit Shenjt, bëni çmos t'i keni me begati për edukimin e Kishës."* (1 Kor 14,12)

## 1. Dëshironi dashurinë – nëpërmes të profecisë

*"Kërkoni të fitoni dashurinë. Dëshironi edhe dhuratat e Shpirtit Shenjt, sidomos atë të profecisë."* (1 Kor 14,1)

Sa herë kemi dëgjuar këshillën se duhet ta duam njëri-tjetrin? Kur dëgjojmë këtë pyesim Zotërinë: Si? Po. Dëshiroj të dua. Dëshiroj ta trashëgoj këtë dhe të dua ashtu si ti do. Zotëri, më trego, më mëso si? Kur Zotëria u përgjigj një herë, në thellësinë e zemrës sime tha: "Shërbehu me dhuratat e mia. Shpirti im banon në ty – shërbehu me dhuratat e mia." Shkrimi Shenjt na thotë po ashtu se "...Hyu është i njëjtë – Ai bën gjithçka në të gjithë." (1 Kor 12,6) Prandaj janë fjalët e profecisë, sepse janë të frymëzuara nga Hyji, ato me të cilat ne, në të vërtetë, e duam njëri-tjetrin, sepse ndajmë në mes veti dashurinë e tij, brengën, shërimin dhe udhëheqjen. Nëse në zemrën tuaj dëgjoni fjalët e profecisë derisa luteni me dikë, a ka dashuri më të madhe se sa t'i ndani ato fjalë me të? Këtë e bëni duke u shërbyer me dhuratën e profecisë. Nëse Zotëria u ka dhënë porosi për ndonjë person ose për bashkësinë tuaj, ju atë person ose bashkësi e doni nëse me ta e ndani ata porosi! Nëse keni dhuratën për të mësuar, i doni duke ndarë me ta dhuratën që Ai u ka dhënë. Të duash do të thotë të ndash me të tjerët!

Nganjëherë është shumë vështirë t'i duash disa njerëz, por duke u shërbyer me dhuratat e Shpirtit Shenjt, e sidomos me profecinë, lejojmë që Zotëria nëpërmes nesh t'i kryejë veprat e veta. Edhe nëse ne vetë nuk ndiejmë dashurinë, ne faktikisht duam. Në të vërtetë, ne i lejojmë dashurisë së tij, fjalëve të tij që të rrjedhin nëpër ne dhe të bëhen bekim i madh si për atë që profetizon, ashtu edhe për ata që e dëgjojnë. Në atë rast profecia kalon nëpër ne, rrjedh prej Zotërisë tek vëllezërit tanë dhe motrat tona, duke i bekuar dhe ndihmuar.

Për këtë flet kapitulli i trembëdhjetë i Letrës drejtuar Korintasve: Himni i dashurisë nga Shën Pali. Ky kapitull shpesh lexohet në martesë dhe në raste të tjera; domethënia burimore e tij shpesh kuptohet gabimisht, sidomos pjesa që ka të bëjë me dhuratën e fjalës. Qëllimi i Shën Palit, duke shkruar këto fjalë për dashurinë, ka qenë që t'ua shpjegojë Korintasve dhe neve - trashëgimtarëve të tij në besim - që dhurata e fjalës na është dhënë që të rritemi në dashuri ndaj Zotërisë, si dhe ndaj vëllezërve dhe motrave.

## 2. Bashkëpunoni me dashurinë e Tij

*"Zoti është Dashuri."* (1 Gjn 4,15) Zoti më shumë dëshiron të na flasë ne, se ne dëshirojmë ta dëgjojmë atë, kështu që do të duhej bashkëpunuar me dashurinë e tij sa më mirë që dimë.

Nëse dimë të pranojmë atë që Zotëria na flet, dhe atë ta ndajmë me të tjerët, ne, në të vërtetë, shërbehemi me dhuratën e profecisë; kur jemi të hapur për atë që Shpirti lutet (Rom 8,26), lusim në gjuhë, e kur jemi të hapur për atë që Zotëria bën me fuqi dhe këtë e ndajmë me të tjerët, atëherë manifestojmë dhuratën e shërimit dhe të mrekullive. Me bashkëpunimin tonë, nëpërmes të shfrytëzimit të dhuratave të Shpirtit Shenjt, rrjedh dashuria e Atit.

Jezusi tha: “...do ta njihni të vërtetën dhe e vërteta do të ju lirojë” (Gjn 8, 32). Jezusi e ka dashur veten. E ka ditur saktësisht kush është. E ka dashur Atin dhe e ka ditur se është i dashur nga Ai, dhe duke iu falënderuar kësaj ka qenë i gatshëm të bëjë atë që Ati ka kërkuar prej tij. (...) që ta dijë bota se e dua Atin dhe se bëj ashtu si më urdhëron Ai.” (Gjn 14 31). Lutja për shërimin e mendimit për veten tonë do të duhej të ishte në fillim të fillimit të rritjes sonë shpirtërore – në mënyrë që të kuptojmë se jemi të dashur (ashtu sikurse e dinte Jezusi). Dhe pasi që edhe ne e duam Zotërinë, do të jemi të gatshëm të bëjmë veprat e tij. Kjo është arsyeja që Ai na i jep dhuratat – sepse beson në ne dhe sepse na do. Të dërguarit e Jezusit vazhdon me pagëzimin e tij. Kjo është një ide madhështore.

Zotëria na jep nga Shpirti i vet, sepse beson se Shpirtin e tij dhe dhuratat e tija do t'i ndajmë me të tjerët, pikërisht ashtu si ma ka dhuruar mua meshtarinë time, sepse beson te unë, dhe beson se do të shërbehem me të dhe do ta ndajë me të tjerët. Të gjitha këto janë bashkëpunimi me dashurinë e tij: ndarja e dashurisë së tij, ndarja e Shpirtit të tij, ndarja e dhuratave të tij, ndarja e meshtarisë së tij.

*Përgjigja: “Eheu, O Zot, Hyj. Po unë nuk dijë të flas, sepse jam fëmijë! Por Zoti m'u përgjigj: “Mos thuaj: 'Jam fëmijë' por shko te të gjithë ata që po të dërgoj dhe thuaju gjithçka që do të urdhëroj! Mos kij kurrfarë frike para tyre, sepse unë jam me ty për të mbrojtur – është fjala e Zotit. Atëherë Zoti e shtriu dorën e vet, ma preku gojën time e më tha: Ja unë po i vë fjalët e mia në gojën tënde!”*

### 3. Jini të hapur për veprimin e Zotit

*Kurse, ai që profetizon u flet njerëzve: edukon, qorton, ngushëllon. Ai që flet në gjuhë të huaj, edukon veten, kurse ai që profetizon, edukon bashkësinë. (1 Kor 14, 3-4).*

Është vepër e Zotit që në Shpirtin e tij ta ndihmojmë njëri-tjetrin dhe që përgjegjësia jonë të mundësojë manifestimin e porosisë së tij dhe veprave të tij.

Në librin e tij: “Dhurata e profecisë” Kenneth Hagin shkruan: “Të ndërtohet do të thotë të plotësosh. Shkencëtarët grekë shërbehën me fjalën “mbush”, në kuptimin që do ta përdornim ne, për shembull, për akumulatorin, që është një përkthim më i përafërt. “Ai që flet në gjuhë të huaj, ndërton veten.” Ai, në të vërtetë, ndërton dhe “mbush” veten, ashtu si mbushet akumulatori. Tani e shohim qartë se sa është e nevojshme që besimtarët e mbushur me Shpirtin Shenjt, të lutën shumë në gjuhë në jetën e tyre personale të lutjes. Kjo i ndërton. Kjo i mbush. Kështu ata ndërtohen shpirtërisht. Pastaj, kur bashkohemi si trup, bashkohemi që të ndërtohem në mes veti. Kështu profecia është dhuruar që të ndërtohet Kisha, që ajo të ndërtohet në kuptimin shpirtëror, që të mbushet me forcën shpirtërore, si akumulatori.

Kisha duhet që të ndërtohet, “mbushet”, plotësohet me forcë me anë të profecisë. Kjo është vepra e Zotit për popullin e tij. Ai na mbush me forcë shpirtërore. Si është e mundur e gjithë kjo? Ja disa shembuj profecish me të cilat është shërbyer Zoti për ndërtimin, trimërimin dhe ngushëllimin e popullit të vet.

Profeci ndërtimi: “Le të këndojnë zemrat tuaja këngën e falënderimit, populli im, sepse Zotëria, Zoti juaj gëzohet me ju. Le të ju kumbojnë zemrat tuaja me falënderim dhe dashuri ndaj meje. Gëzohuni! Gëzohuni! Gëzohuni në Zotërinë tuaj! Zemrat le të ju këndojnë - aleluja, populli im. Gëzohuni në mua.”

Profeci trimërimi: “Dijeni se shkoj para jush, shkoj që të ju bëj gati udhën. Më ndiqni! Ndiqeni rrugën time! Më ndiqni dhe dijeni se jam me ju kah do që të shkoni dhe çka do që të bëni!”

Profeci ngushëllimi: “Mbushuni me paqen time. Le të mbesin mënjatë brengat dhe travajet e botës. Drejtoni shikimin tuaj në mua dhe në dashurinë time për ju. Në qetësinë e zemrës lejoni që të ju udhëheq Shpirti im.

#### 4. Jini të vetëdijshëm për shugurimin e profecisë që keni pranuar

Ashtu si shohim nga Shkrimi Shenjt, Pjetri ka qenë i shuguruar ditën e Rrëshajave: *“Atëherë Pjetri bashkë me të Njëmbëdhjetët u çua në këmbë, e ngriti zërin dhe tha: ‘Burra judeas dhe ju të gjithë që banoni në Jerusalem, mirë ta dini këtë gjë e me kujdes dëgjoni fjalët e mia! Këta njerëz nuk janë të dehur, siç po mendoni ju – ju po shihni se është ora tre e mëngjesit – por po shkon në vend fjala që parafoni Joeli profet: ‘Në ditën e fundit - thotë Hyu: Do ta ndikoj Shpirtin tim në çdo njeri dhe bijtë tuaj e bijat tuaja do të profetizojnë, djelmohat tuaj do të shohin vegime, e pleqtë tuaj do ëndërrojnë. Madje edhe mbi shërbëtorë e shërbëtore të mia atë ditë do ta ndikoj Shpirtin tim e do të profetizojnë. (Vap 2, 14-18)*

Edhe sot, si atëherë, shugurimi është ndjenjë e pranisë dhe nxitjes së Zotërisë – nxitje në shpirt që ta themi porosinë e Zotit. Shugurimi shpesh mund të ndjehet në manifestime fizike – shuplaka të rënduara, ndjenjë e ngrohtësisë në tërë trupin ose rrahje të shpejtuara të zemrës. Në të shumtën e rasteve manifestohet me rrahje të shpejtuara të zemrës. Shpesh shugurimi mund të ndjehet si ndjenjë e paqes së thellë, ndjenjë e dashurisë së Zotërisë dhe në shumë mënyra të tjera. Sikur me këtë Zotëria të donte të na thotë që të jemi të vëmendshëm se do të na flasë dhe se duhet të dëgjojmë.

Pasi që ta ndjeni shugurimin, thojeni atë që keni ndjerë në vete. Mos kundërshtoni, mos shqyrtoni, por thjeshtë – thojeni!

Kur bashkohemi në uratë besojmë se Ati do t'i plotësojë nevojat tona nëpër fjalët e profecisë së tij. Ndjenja e shugurimit mund të jetë nxitje e madhe. Pritni shugurimin!

Ja disa dëshmi, se si disa njerëz e kanë ndjerë shugurimin kur të parën herë e kanë shijuar dhuratën e profecisë:

“Mpirje duarsh”

“Ngrohtësi në zemër”

“Ngrohtësi gjithëpërfshirëse në trup.”

“Ndjenjë paqeje dhe besimi.”

“Ndjeja se zemra po më dridhej.”

“Ndjeva një dashuri të madhe se si dilte nga unë dhe fjalët që më erdhën, thjeshtë, më duhej t'i thosha. ‘Ua kam dhënë dritën. Merreni atë dritë, dërgojani botës në paqe, dashuri dhe ngazëllim... ‘ Zemra më dridhej.”

“Ngrohtësia më shkante nga kraharori kah koka dhe veshët, derisa në lukth kisha ndjenjën si në rastet kur kam tremë. Kurse ndjenja e paqes ishte me të vërtetë e mrekullueshme. Sa shumë e kam dëshiruar këtë.”

“Kisha ndjenjë shumë të fuqishme në lukth, kurse ajo (profecia) thoshte fuqishëm se si Ai na e jep dashurinë e tij. Dëshiroja të qaj me gjithë zemër. Lavdi Zotërisë!”

“Ndjeva një ligështi të madhe. Zemra më rrihte fuqishëm, dhe ja fjalët që ndjeva: ‘Bija ime, ndihmoji popullit tim që të kthehet.”



“Kisha përshtypjen se i gjithë trupi po më lëviz, ndjeva ngrohtësi në tërë trupin kurse zemra më rrihte fort. Edhe më parë kisha profetizuar, por kjo sot ishte veçanërisht e fuqishme.”

“Ndjeva se si dashuria e Tij rrjedh nëpër mua. Tha: ‘Ju jeni fëmijët e mi. Aq shumë ju dua.’ Ato fjalë më ktheheshin pa pra. Nuk isha aq e sigurt si herëve tjera, por fjalët ishin aty. Atëherë zemra filloitë më rrahë aq fuqishëm, sa që e dita se më duhet t’i them.”

“Të therura nëpër tërë lëkurën, Jezusi tha: “Gëzohu dhe ji e lumtur!”

“Ndjeva një gëzim të madh dhe se si një dritë e bardhë ma mbulon fytyrën dhe më rrethon. Më përfshiu një gëzim i papërshtueshëm dhe e dita se më duhet t’i them këto fjalë: ‘Ati dhe unë jemi një.’ E dija se vijnë prej Zotërisë. Ty të qoftë lavdia, Jezus!”

“E ndjeja se po flet Zotëria: ‘Mos ki frikë!’ E dija se Zotëria është me mua.”

“Kisha një vizion të jashtëzakonshëm të veshjes së tij shenjte.”

“Ishte hera e parë që po dëgjoja ligjëratë mbi profecinë. Gjatë tërë kohës ndjeja aso paqe, sa që më dukej se ai vetë është profecia, pa kurrfarë fjalësh. Tha: “Kjo është dita që e kam zgjedhur që të fillosh të profetizosh.”

“Duart dhe këmbët i kisha të rënda si plumb. Edhe sot ndjeva një rraskapitje të atillë, sa mezi ‘u zvarrita’ deri tek mikrofonit që të dëshmoj.”

“Kisha vizionin e Jezusit në kalvar. E përsëriste pa pushim: ‘Kam vdekur për ty!’ , por unë nuk e thashë atë. Pastaj mu afrua një zonjë që rrinte para meje dhe më tha: ‘Fëmija im, të dua aq shumë, pse kam vdekur për ty.’ Kështu, më në fund, ajo ma tha mua atë që unë duhej t’ua thosha të tjerëve.”

“Zotëria ishte me ne; të gjithëve na përqafoi dhe ne shkuam me të. Vdiqëm me të dhe tani po na jep jetën e re dhe po na shpie tek Ati. Pashë një dritë të madhe, kurse Zotëria, në ngrykë, na çonte drejt asaj drite.”

“Luteshim për dhuratën e profecisë, dhe derisa po luteshim, pamë shumë profetë: Elizeun, Ezrën, Barukun, Jereminë. Silleshin rreth nesh duke lavdëruar Zotin dhe duke na porositur tek Zoti: Ishim pra në duar të sigurta!”

## 5. Dëgjoni fjalët në zemrën tuaj

Mbajeni në mend, se dhurata e profecisë, edhe në këtë çast, është vepruese në ju. Nëse keni pranuar pagëzimin në Shpirtin Shenjt, me një ndihmë të vogël mund t’i hapeni dhuratës së profecisë. A i keni ndjerë në vete ndonjëherë fjalët në takimin e lutjes? A keni insistuar me ngulm që t’i “largoni”? Do të thosha se shumë nga ju, duke lexuar këta rreshta, kanë pranuar profeci, por në një çast e keni larguar. Kjo është koha e shpëtimit. Tani është koha që të hapeni dhe t’i thoni ato fjalë! Në të vërtetë, është fjala për një përvojë jashtëzakonisht të bukur! Kur t’i hapeni njëherë kësaj dhurate, dhe më nuk frikoheni të flisni, Zotëria do t’u japë profeci edhe kur të bisedoni me dike në telefon. Profecia individuale është vërtet bekim i madh. Ajo, në Çastin e duhur, nuk i është drejtuar bashkësisë, por një personi të caktuar.

Nganjëherë fjalët profetike do t’ju vijnë si porosi personale për ju. Para disa vitesh, gjatë lutjes sime të mëngjesit, kam pranuar profecinë e drejtuar pikërisht mua. Kishte të bënte me Jamajkën, ku kisha ndërmend të shkoja për mbajtjen e seminareve për disa javë. Kisha në dorë ditarin e lutjes dhe e shkrova atë profeci shumë të bukur dhe të gjatë nga Zotëria. Në të thuhej se si do ta përqafonte Jamajkën, dhe do ta shpëtonte popullin e vet, i cili gjendej në terr, vetëm nëse do ta lavdërojnë me gjithë zemër. Theksi ishte në lavdërim. Nëse do ta lavdërojnë, Ai do t’i shpëtojë. Ajo ujdhesë iu kthye lavdërimit të Zotit dhe vërtet ishin të shpëtuar. Para zgjedhjeve të fundit 99% ishte e sigurt se do të fitonin komunistët. Mirëpo Jamajka votoi kundër komunistëve! Ishte një kthesë shumë e madhe. Njerëzit që luteshin, e dinin se kjo është vepër e Zotit, sepse në mbarë vendin ishin të siguruara rojet

gjatë tërë natës. Në një takim ungjillor, para zgjedhjeve, 40 000 vetë ia dorëzuan jetën e vet Jezusit. Duke iu falënderuar lutjes dhe lavdërimit, Zotëria e ka ndërruar krejtësisht rrjedhën e ngjarjeve. Kurse mua më ishte shpallur rezultati paraprakisht – nëpërmes profecisë.

Profecia lajmërohet para së gjithash asisoj, kur zërin e Zotërisë e ndiejmë në zemër, e pastaj e themi në besim, kur ndiejmë shugurimin. Nëse jeni i vetmuar, në lutje personale, dhe ndjeni se po ju vijnë fjalët nga Zotëria, shkruani ato, sepse sipas gjase, ato janë fjalë të drejtuara pikërisht juve. Mos i lejoni vetes që fjalët e Zotërisë të kalojnë pranë jush! Nëse gjendeni në një tubim të madh dhe ndjeni se keni profeci, por nuk jeni i sigurt, personi pranë jush le t'i vejë duart në krahët tuaj dhe le të lutet për ju. Dëshira për profetizim me atë rast as nuk do të zvogëlohet as nuk do të rritet. Kur nuk i themi fjalët e Zotërisë, kemi bërë lëshim të madh. Vërtet është e dhimbshme që të jesh në takimin e lutjes, ku nuk ka profetizim. Ashtu si thotë kënga: “Vetëm të të prek dhe të prek veshjen tënde...” Dëgjojeni dhe thojeni fjalën e Zotit, kur të ndjeni shugurimin! Ai është aty, po kalon pranë.

Nëse dëgjojmë, fjala e Zotit do të na vijë në mënyra të ndryshme:

1. Profecia nëpërmes këngës.
2. Profecia nëpërmes të vizionit.
3. Porosia profetike e zbuluar në tërësi.
4. Vetëm disa fjalë të zbuluara. Posa t'i themi në besim, pasojnë të tjerat.
5. Ndjenja se Zotëria dëshiron që të flasim. Kur t'i dorëzohemi dhe hapemi, fjalët e profecisë vijnë vetë.
6. Vetëm një fjalë, për shembull, fjala “lavdërim”. Kur t'i hapemi dhe lëshohemi, vijnë të tjerat.

Gjatë kohës së takimit të lutjes, si dhe gjatë lutjes personale, nuk duhet që vetëm të lutemi dhe të kërkojmë, por edhe të dëgjojmë. Ne i flasim Zotërisë dhe ai na flet neve – nëse dimë ta dëgjojmë.

Cikli karizmatik rrjedh kështu:

LAVDËRIMI, LUTJA, PROFECIA.

## 6. Lutuni për dhuratën e dallimit të shpirtave

*“Prandaj, po ju them: Askush që flet nën ndikimin e Shpirtit të Hyut, nuk thotë: “Qoftë mallkuar Jezusi!” , por edhe askush nuk mund të thotë as: “Jezusi është Zot!” veçse nën ndikimin e Shpirtit Shenjt.” (1 Kor 12,3).* Dallimi është intuitë, sipas së cilës e dini kur diçka është vërtet nga Shpirti Shenjt. Le ta bëjë dallimin bashkësia, se a është profecia jonë vërtetë nga Zotëria, sepse, në të vërtetë, kur e themi fjalën e Zotit, “shkojmë në besim”. Nëse Fjala e Zotit në mënyrë pozitive e prek shpirtin e të tjerëve, mund të themi se profecia vërtet është nga Shpirti Shenjt. Kur njerëzit profetizojnë, unë dëgjoj. Profecia zakonisht ndërton: më ndërton mua, dhe, po ashtu, mund ta ndërtoj se e ndërton bashkësinë. Më jep ndjenjën e pranisë së Zotërisë dhe kështu unë e di se është vërtet nga Shpirti Shenjt.

E dimë, gjithsesi, se profecia nuk është gjithmonë pozitive, por edhe atëherë kur profecia na korrigjon ose na fton në falje, është fjala për porosi pozitive nga Zotëria për ndërtimin e bashkësisë ose të vetes sonë.

Kam për qëllimi që me këtë libër t'ju nxis të hyni në përvojën e dhuratës së profecisë dhe të mësoni diçka për dallimin e profecive. Fjala më e vështirë për formulim është Fjala e Zotërisë. Prandaj, në vend që njerëzit t'i dekurajojmë me rregulla të panumërta të dallimit, është më mirë që njëri-tjetrit t'i japim kurajë. Përherë e më shumë jam i bindur se njerëzit duhet t'i nxisim të profetizojnë, e më vonë, sipas nevojës, eventualisht, t'i korrigjojmë. Secila bashkësi lutjeje duhet t'i pranojë njohuritë themelore mbi dhuratat e Shpirtit Shenjt, sidomos për dhuratën e gjuhëve dhe të profecisë, pastaj do duhej vazhduar me fjalët që do t'i nxisnin njerëzit të profetizojnë, ashtu si i frymëzon Zotëria.

Ekzistojnë shumë libra të shkëlqyer mbi dallimin e profecive. Do të sjell këtu vetëm një kriter nga libri i Bruce Yokum - *Profecia*: “Secila bashkësi duhet pajtuar mbi mënyrën se si do t’i këmbëjë përvojat e profecisë dhe të mundësojë dhënien e këshillave ose të korrigjimeve. Në shumicën e rasteve, anëtarët e bashkësisë nuk duhet që individualisht të këshillojnë ose të korrigjojnë ata që profetizojnë. Ata, në të vërtetë, së pari duhet që dallimin e tyre ta diskutojnë me udhëheqësit e bashkësisë, të cilët, pastaj të marrin përgjegjësinë e dhënies së informatës kthyesë, gjegjësisht, aty ku është nevoja - korrigjimi i atyre që profetizojnë.”

Në rastin ideal duhej të ekzistonte grupi i vogël i atyre që janë shumë të fortë në fushën e dhuratës së profecisë. Ata duhet, që, gjatë takimit të lutjes, të rrinë afër njëri-tjetrit. Kështu, ata si grup i ngarkuar me dhuratën e fjalës, mund t’i shqyrtojnë profecitë e thëna nga anëtarët tjerë, si edhe të vetë atyre. Sepse njerëzit, të cilët janë të hapur, janë të hapur po ashtu, edhe për dallimin e profecive të tjera që thuhën. Në çdo takim më të madh të lutjes, duhet të ekzistojë grupi i ngarkuar për dhuratën e fjalës, në mënyrë që udhëheqësi i bashkësisë të ketë mundësinë të konsultohet me të, nëse bëhet fjalë për profeci si dhe me anëtarët, të cilët rregullisht i thonë profecitë. Ashtu si thotë Bruce Yokum: “(...) së pari shqyrtoni jetën e individit, e pastaj ndikimin e profecisë së tij në bashkësi.”

Njëra prej mënyrave, me të cilën mund tashqyrtojmë me siguri profecinë në takimin e lutjes, është ajo që ia shtrojmë vetes këto pyetje: A e ngrit profecia nivelin e lavdërimit në takim? Duke ngritur nivelin e lavdërimit, a sjell fryte të mira? Kur ndodh profecia, dialogu në mes të bashkësisë dhe Zotërisë bëhet më i fuqishëm. Kur flet Zotëria do të ngrihet niveli i lavdërimit dhe madhërimit; me fjalë të tjera, do të ketë fryte të mira.

Edhe një mënyrë, me të cilën mund të shërbehen udhëheqësit, është ajo e përcjelljes me kujdes të reagimit të bashkësisë. Nëse është fjala për profeci të vërtetë, do të reagojë e tërë bashkësia, sepse është i prekur secili shpirt. Reagimi i tyre duhet të jetë i zëshëm, për shembull: Ty të qoftë lavdia, Jezus! Të falem nderit, Jezus!” Mirëpo, nganjëherë, kur dëgjoj se vetëm një ose dy thonë: “Të falem nderit, Jezus!”, dyshoj në vete, sepse mendoj se e thonë vetëm për shkak të shprehisë. Por, ka edhe raste kur e ndiej se bashkësia është e prekur dhe e ndiej praninë e Zotërisë nëpër fjalën e profecisë. Profecia e vërtetë sjell me vete thellimin e ndjenjës së afërsisë së Zotërisë, kështu ngrihet niveli i lavdërimit. Në raste të tilla, njerëzit janë më të hapur ndaj madhërimit dhe lavdërimit, se sa që ishin para thënies së profecisë.

Kur thuhën fjalët profetike, ndodhin shërime shpirtërore; duke dëgjuar fjalë profetike, hapen sytë e shpirtit tonë. Kur flet Zotëria, shpirti ynë bëhet më i hapur për Shpirtin Shenjt, i cili flet dhe vepron. Kur Shpirti Shenjt në atë mënyrë e prek shpirtin tuaj, do t’ju rritet *ndjeshmëria*. Këtë mund ta krahasojmë me përvojën që pason pas pranimit të *pagëzimit në Shpirtin Shenjt*, kur disa njerëz për të parën herë me të vërtetë e përjetojnë thellësisht praninë e Zotit në kremtimin e meshës. Ajo ndjenjë e pranisë, atëherë e mpreh aftësinë e dallimit si dhe vetëdijen. Ekziston një lidhje reciproke në mes të përvojave tona dhe të hapjes shpirtërore. Për shembull, kur dëgjojmë muzikën klasike për të parën herë. Për një herë kuptojmë se derisa dëgjojmë, veshët tanë hapen dhe adaptohen me atë përvojë të re. Si pasojë e kësaj, ndodh rritja e aftësisë së të kënaqurit në atë lloj muzike.

Janë disa rregulla në dallimin e profecive: gjithmonë duhet të vlerësohen në dritën e mësimin të krishterë dhe biblik. Atë që thotë mësimi zyrtar i Kishës, kurrë nuk mund të jetë në kontradiktë me njohjen e ndonjë personi. Nganjëherë jemi tejet subjektivë në përpjekjet tona të dëgjimit të Shpirtit Shenjt, prandaj mendimet dhe idealet tona mund të na okupojnë deri në atë masë sa mund të flasim atë që, në të vërtetë, dëshirojmë të dëgjojmë. Gjithmonë duhet të udhëhiqemi me kritere objektive. Mësimi Kishitar dhe biblik ka gjithmonë përparësi.

Edhe pse dëshiroj që ta thjeshtoj sa më shumë që është e mundur dallimin e profecisë, duhet thënë se kjo, shpesh herë, është shumë e vështirë, për shkak se vetë njeriu është qenie e ndërliqshme. Megjithatë, e dimë se profecitë i jep Zotëria, se individëve ua ka dhënë fjalët profetike, ashtu si lexojmë në Veprat e apostujve; dhe ndoshta këtë na e thotë edhe përvoja jonë personale. Nganjëherë profecia është e pastër, e nganjëherë jo, së paku jo në tërësi. Madje, edhe profecia e vërtetë mund të ketë shkallëzime të pastërtisë, sepse në të mund të përzihen tendencat tona, por do të thosha se kryesisht ajo vjen nga Zotëria. Rrallë ka ndodhur që të dëgjoj profeci të rreme. Më kujtohet një rast në Universitetin Lloyolla në New Orleans, kur një person tha: "Fëmijët e mi, si do të mund të isha unë në një copë buke?" Menjëherë ka reaguuar Atë Harold Cohen duke shpjeguar mësimin e Kishës mbi PRANINË E VËRTETË TË JEZUSIT. Edhe shokët e mi, të pranishëm aty, kanë dëshmuar për një ftohtësi të pakëndshme në trup, në çastin kur është thënë ajo profeci. Profecia e rreme kryesisht është e qartë për pjesën më të madhe të bashkësisë së krishterë dhe i kundërshton mësimin Kishtar dhe biblik.

Kështu pra, profecia mund të vijë nga Shpirti Shenjt, nga shpirti i keq ose nga mendja jonë. Nganjëherë lexojmë diçka që tingëllon bukur dhe atë e themi në takimin e lutjes, duke pritur se do të konsiderohet profeci, por, kur dikush bën diçka kësaj gjë - sikurse që kam thënë - do të vëreni se bashkësia nuk është nxitur që, më me forcë, ta lavdërojë Zotërinë. Bashkësia mund të reagojë me një: "Të falem nderit, Jezus!", por nuk do të ndodhë ndryshimi i vërtetë i disponimit të të pranishmëve. Kjo nuk është profeci, dhe situatën duhet sqaruar me ndihmën e anëtarëve të bashkësisë, të ngarkuar për dhuratën e fjalës. Nëse individët shpesh (më gjatë se tri javë rresht) thonë këso jo-profecish, është e nevojshme që udhëheqësit të ju drejtohen në mënyrë diskrete, me butësi dhe dashuri, jashtë takimit të lutjes. Jo-profecia është ajo që vjen nga vetë personi. Për shembull, nëse imagjinoj diçka sikur: "Fëmijët e mi, ju dua. Jeni mbledhur këtu dhe dëshiroj që të ju bekoj", kjo është, pra, e menduar, dhe nuk është profeci. Është e vërtetë se duhet të ndjehemi të lirë që të eksperimentojmë me dhuratat (ashtu si thonë shumë autorë), sepse nëse nuk do të ndjehemi të lirë ta thoni atë që e konsideroni fjalë të Zotërisë të drejtuar të tjerëve, nuk do ta thoni kurrë. Të eksperimentosh me dhuratat, do të thotë t'i kushtoheni asaj që mendoni se Shpirti Shenjt flet brenda qenies suaj dhe në momentin e caktuar bën. Kur profetizojmë, duhet të vendosim një kufi të caktuar, që fjalët tona të mos rrjedhin në vend të fjalëve të Shpirtit Shenjt.

Nëse nuk eksperimentoni, dhe mendoni se Shpirti Shenjt vepron, dhe nuk bashkëpunoni me të, a s'do të mund të pohohej se, në të vërtetë, e bllokoni Shpirtin Shenjt? A thua, e refuzoni bashkëpunimin me Shpirtin Shenjt. Ne dëshirojmë që të bashkëpunojmë me Shpirtin Shenjt, i cili dëshiron të veprojmë në ato lëmi, duke kujtuar me atë rast fjalët e Shën. Palit: "*Dëshironi edhe dhuratat e Shpirtit Shenjt, sidomos atë të profecisë.*" Në rastin ideal duhet të ketë edhe më shumë mësim mbi dhuratat, sidomos të profecisë, ku do t'u thuhej njerëzve që të presin për deri sa ta dëgjojnë fjalën në zemër, dhe vetëm pastaj le t'i hapen asaj dhurate. Shumica e njerëzve mëson mbi profecinë, duke dëgjuar ato në takimet e lutjeve. Shumica e të rinjve në bashkësi, duke mos e ditur se ato fjalë janë prej Zotërisë, konsideron se njerëzit i mendojnë vetë, dhe kështu edhe ata fillojnë të bëjnë të njëjtën gjë. Njerëzit duhet për t'i mësuar mirë se si ta dëgjojnë zërin e brendshëm dhe të jenë të hapur për fjalën që Zotëria u flet në zemër. Besoj se ligjëratat e hapura mbi dhuratat e Shpirtit Shenjt në masë të madhe do ta zvogëlonin nevojën e korigjimeve. Mirëpo, tani për tani, mund të themi sigurt, se ka shumë pak përmirësime të jo-profecive. Korigjimi me qëllim të shfrytëzimit të drejtë të dhuratave është një lëmi shumë delikate e Përtëritjes në Shpirt, sepse qëllimi është nxitja e jo dekurajimi i njerëzve. "*Mos e pengoni Shpirtin Shenjt të veprojë në ju! Profecitë mos i përbuzni! Çdo gjë shqyrtoni me kujdes: mbani të mirën! Çdo lloj të keqeje rrini larg!*" (1 Sel 5, 19-22)

## 7. Profecia sjell fryte të mira

*“Kështu, pra, do t’i njihni profetët prej veprave të tyre.” (Mt 7,20)*

Profecia gjithmonë sjell fryte të mira. Gjatë kohës së takimit të lutjeve, profecia e vërtetë në mes të të pranishmëve do ta ngritë nivelin e lavdërimit. Niveli i lavdërimit është shpesh njëra prej fryteve që duhet t’i dallojmë pas fjalës profetike. Fjala që vjen prej Zotërisë gjithherë do të veprojë në zemër, për deri sa reagimi i drejtë i zemrës është gjithmonë lavdërimi i Zotërisë. Madje, edhe nëse është fjala profetike *fjalë korrigjimi*, do të dimë ta dallojmë se a vjen ajo vërtet nga Zotëria dhe do të reagojmë ndaj saj me lavdërim. “Të falënderoj, Zotëri, se e di se fjalët që ke thënë janë të vërteta.” Do ta citoj një pjesë nga libri i atë Joe Lange *Të shoqërohesh me Jezusin*: “Nëse bashkësia reagon në profecinë e vërtetë, ai reagim do të rritet në dashuri të dukshme, që është vërtetim përfundimtar i pranisë së Shpirtit Shenjt. Kjo vlen edhe për individin, i cili shërbehet rregullisht me ndonjë dhuratë të Shpirtit Shenjt. Pa marrë parasysh a është fjala për profeci, këshillë apo shërim, atij që shërbehet me atë dhuratë në dashuri, duhet t’i besohet si personit të përfshirë nga Shpirti.”

Sikurse edhe në jetë përgjithësisht, njerëzit rriten në dashuri, duke iu falënderuar komunikimit; djaloshi dhe vajza që janë në lidhje, kalojnë shumë kohë së bashku duke komunikuar dhe duke këmbyer mendimet, idealet, pikëpamjet, ndjenjat dhe synimet. Komunikimi ka për qëllim që t’i hapet dera dashurisë. Nuk mund t’i duam njerëzit, të cilët me të vërtetë nuk i njohim. Prandaj, për deri sa e madhërojmë Zotërinë, kurse Ai na drejtohet nëpërmjet profecisë, bashkësia rritet në njohjen e Zotërisë Jezu Krishtit, dhe jo vetëm individualisht por edhe bashkërisht, nëpër zhvillimin e ciklit karizmatik të lavdërimit, lutjes dhe profecisë. Frytet e mira bëhen të dukshme përherë e më shumë asisoj, kur përtërihen mendjet, zemrat, madje edhe trupat e njerëzve, dhe pa ndërprerje thellohet raporti në mes të bashkësisë, individëve që e përbëjnë dhe Zotërisë. Frytet e mira të profecisë kanë të bëjnë me njohjen e mendimit të Zotërisë në dialogun që zgjatë javë pas jave, duke thelluar ashtu raportin e dashurisë.

Fryt i mirë i profecisë në bashkësi është edhe hapja për dëgjimin e Zotërisë në lutjen personale. Personalisht mendoj se secili që lutet në gjuhë gjatë dhe shpesh, me kohë do ta dëgjojë edhe shtjellimin e gjuhës së vet të lutjes, thellë në shpirtin e vet. Është mirë madje që atëherë shtjellimi të shkruhet për shqyrtim të mëpastajmë.

Fryt i mirë i profecisë në takimet e lutjeve, është edhe ai që na bën të ndjeshëm për pranimin e profecisë ose shtjellimin e gjuhëve në çastet që ia kushtojmë lutjes personale. Nga përvoja e di se njerëzit, të cilët kanë përparuar në dhuratën e profecisë, e dëgjojnë Zotërinë edhe jashtë takimit të lutjeve, kështu që frytet e mira të profecisë nuk ndjehen vetëm gjatë takimit të lutjeve, por gjithashtu edhe jashtë tij.

Zotëria na këshillon nëpërmjet të dhuratës së profecisë. Mësimi profetik ndodh kur një, dy ose tre vetë japin këshillën nëpërmes fjalës profetike. Secili nga ata me atë rast sjell një a dy rreshta, ose një pjesë të profecisë, kështu që, në të vërtetë, është Zotëria ai që jep këshillën nëpërmes të dy ose tre vetëve që dëgjojnë fjalët e tij. Profecia e këshillës, e cila i vjen bashkësisë drejtpërdrejt nga Zotëria, është njëri nga frytet e profecisë. Është shumë me rëndësi, me atë rast, të jemi të vetëdijsëm, se fjalët e Zotërisë, të drejtuara bashkësisë nëpërmes të dhuratave të profecisë, e tejkalojnë shumë Katekizmin e kishës Katolike, madje edhe predikimin e së dielës. Mësimet profetike vërtet janë shumë të fuqishme, por kurrë nuk kam hasë diçka të shkruar për to, përveç që i kam përjetuar. Ata që pranojnë këshillën profetike, në të vërtetë, janë një në Shpirt: ata janë të harmonizuar dhe të sinkronizuar në mes veti, asisoj, kur Zotëria mund të flasë së pari nëpërmes të njërit prej tyre e pastaj nëpërmes të dytit dhe të tretit. Derisa isha në një qytet, lutesha me disa njerëz

të cilët ishin në një harmoni të madhe me mua, dhe gati për çdo javë jepnim mësimë profetike dhe në ato raste Zotëria na mësonte për një temë të caktuar edhe nga disa minuta. Unë thosha një pjesë të profecisë, një person tjetër një pjesë tjetër, dhe e dinim saktësisht se kur ky i dyti e ka përfunduar. E përsëris se kurrë nuk kam vënë re se është shkruar diçka për mësimin profetik, por konsideroj se – nëse të gjithë jemi të gatshëm që të shkojmë deri tek Universiteti Notre Dame që të dëgjojmë folësit më të mirë të vendit - aq më tepër do të duhej që të jemi të gatshëm të dëgjojmë Zotërinë se si e mëson bashkësinë tonë pikërisht aty ku jemi. Kur flasim për frytet e profecisë, nuk nënkuptojmë vetëm fjalën e drejtpërdrejtë të drejtuar bashkësisë gjatë takimit të lutjes, por ajo fjalë si mësim nëpërmes të aplikimit duhet të vazhdojë në jetën tonë të përditshme.

Profecia i ngjan dhuratës së gjuhëve, në kuptimin që na bën të hapur për të gjitha dhuratat tjera; vetëdijesohemi për dashurinë e Zotërisë ndaj nesh, duke e dëgjuar se si flet. Rritemi në dashuri. Kur dëgjojmë Zotërinë duke folur lajmërohet një afërsi e caktuar, një siguri në praninë dhe vërtetësinë e tij, dëshirën e tij për veprimin në ne dhe nëpër ne. Disa nga ne ende merren me përfytyrimin e Zotit të kohës para Konkilit të dytë të Vatikanit: Të Zotit i cili na shikon se si mundohemi, duke menduar mbi atë se cili është dallimi në mes të mëkatit të lehtë dhe mëkatit të vdekshëm. Sikurse në ditët para Konkilit të dytë të Vatikanit investojmë përpjekje të madhe që të mos kalojmë vijën që ndan mëkatin e lehtë nga ai i vdekshëm. Nëse ndodh që të bëjmë mëkat të vdekshëm, frikohemi nga dënimi mental, dhe kështu ushqehet mendimi negativ për Zotin i cili dënon dhe i cili është më tepër gjykatës se sa Zot që fal. Por nëse në profeci dëgjojmë fjalën e Zotërisë, ai do të na flasë me *dashuri*. Shumica e profecive vërteton dashurinë e Zotit ndaj individëve dhe bashkësisë. Kështu si fryt i mirë i profecisë paraqitet përvetësimi i përfytyrimit pozitiv, biblik mbi Zotërinë si Atë përplot dashuri. Sa ma lirshëm që të sillemi me të në lëmin e dhuratave të Shpirtit, më shumë do të interesohemi për jetën në të cilën me Të kemi pjesë dhe bashkëpunojmë, se sa për jetën e cila përbëhet nga shpërblimi dhe dënimi.

*Me këtë gjë lavdërohet im Atë: nëse jepni shumë fryt e dëftoheni nxënës të mi. Sikurse Ati më ka dashur mua, ashtu edhe unë ju kam dashur juve. Qëndroni në dashurinë time!*

Gj 15, 8-9)

## 8. Profecia nuk e cenon vullnetin e lirë të atij që lutet

*“Një nga një, të gjithë mund të profetizoni, në mënyrë që të gjithë të mësojnë e të nxiten kah e mira. Profetët zotërojnë me shpirtin frymëzues të vetin, sepse Hyu nuk është shkaktues shregullimesh, por i paqes.” (1 Kor 31-33)*

Zotëria kurrë nuk do t'ju detyrojë që të thoni diçka që ju nuk dëshironi për të thënë, sepse ajo do të ishte kundër dëshirës suaj. Profecia është dhuratë së cilës i dorëzohemi vullnetarisht, e jo diçka e imponuar. Nganjëherë, në fillim, kur posa të jeni lëshuar në dhuratën e profecisë, Shpirti Shenjt vepron në ju aq fuqishëm saqë vërtetë duhet ta thoni atë që Zotëria ju jep, por pas këtyre fazave të para të thënies së fjalëve profetike, gjithmonë do të jeni të lirë të thoni diçka ose jo. Zotëria kurrë nuk detyron. Parimi i njëjtë vlen edhe për lutjen, si edhe për dashurinë ndaj Zotit: jeni të lirë të luteni ose të mos luteni, ta doni Zotin ose të mos e doni Zotin. Zotëria kurrë nuk do të ju detyrojë që të luteni ose ta doni apo të profetizoni. Thënë në përgjithësi, Zotëria e respekton lirinë tonë personale për bashkëpunim, sepse dashuria është sipas natyrës së vet e lirë. Ne jemi të lirë që të zgjedhim bashkëpunimin me Shpirtin Shenjt nëpërmes të dhuratave të tij. Liria në këtë kuptim vlen edhe për Zotërinë, kështu që mund të lusim për shërimin e dikujt, dhe, megjithatë, ai person të mos shërohet. Atëherë themi: “Ja, mund të jetë fjala për shumë çka. Është e qartë se Zotëria e ka kohën e vet për secilin.” Kjo është njëra nga mundësitë. Po ashtu, Zoti mund t'ju frymëzojë që të luteni për shërim, e ju thoni: “Jo, nuk dëshiroj që të

lutem për shërimin e meshtarit tim. Nuk jam i përgatitur për këtë dhe nuk do ta bëj këtë.” Në raportin e dashurisë, pra, gjithmonë ekziston liria. Kjo vlen edhe për lutjen edhe për dhuratat e Shpirtit. Kur kemi të bëjmë me Zotërinë, veprimi ynë është gjithmonë i lirë.

Karakteristika kryesore e dashurisë së mrekullueshme të Zotërisë ndaj nesh, është pikërisht fakti se ai kurrë nuk e trazon lirinë tonë.

Pasi që profecia është nën kontrollin e atij që profetizon, është me rëndësi që ta lusim Zotërinë që të na ndihmojë që ta themi fjalën profetike në momentin më të përshtatshëm, dhe pastaj të veprojmë në harmoni me atë që e njohim si porosi të tij. Vështirësia më e madhe është, madje edhe në mes të udhëheqësve, se profecia nuk thuhet me zë të lartë. Kjo mund të vërehet gati në çdo bashkësi. Nganjëherë pyes veten se a do të ishin këta njerëz kaq të matur e të kujdesshëm sikur të fitonin një milion euro në lotari!? Besoj se shumica e tyre në atë çast do të kërcente dhe bërtiste. Sa më shumë kemi arsye për këtë kur marrim një porosi prej Zotërisë! Kur përcjellim fjalën që na thotë Zotëria, duhet të flasim me zë që mund të dëgjohet. Disa njerëz nuk janë mësuar që të flasin me zë të lartë, dhe gjithsesi duhet marrë parasysh edhe padenjësinë tonë që të themi fjalën e Zotërisë dhe nënçmimin e vetes. Sidomos femrat flasin me zë të ulët. Kur profecia e thënë nuk dëgjohet sjell shqetësim, në vend që të jetë e pranuar. Këndeje le të kemi kujdes që të flasim me zë të lartë; nëse ka mundësi edhe në mikrofon.

Në rastin ideal profecinë do të duhej thënë në momentin më të përshtatshëm, me zë të lartë, qartë, me maturi dhe përvujtëri, sepse kjo është mënyra se si Shpirti Shenjt vepron në ne.

## **9. Lutuni që profecinë ta thoni në çastin e duhur**

Momenti më i përshtatshëm për thënien e fjalës profetike varet nga struktura e takimit të lutjes. Mendoj se gjysma e parë e takimit të lutjes do duhej kaluar në lavdërim – në lavdërim të pastër që përmban edhe këngën dhe lutjen në gjuhë. Atëherë pas këndimit në gjuhë do të ishte çasti i vërtetë për thënien e profecisë. Dhe përsëri kthehemi në ciklin karizmatik: lavdërimi, lutja, profecia. Momenti më i volitshëm është pas lutjes në gjuhë, sepse i jemi drejtuar Zotërisë dhe tani presim përgjigjen e tij në lutjen tonë nëpërmes të fjalës profetike.

Çaste të pavolitshme ndodhin gjatë kohës së mësimin, dëshmisë ose leximit të Shkrimit. Vërtet, është e nevojshme që të pyesim Zotërinë: “A është ky momenti i duhur?” Nëse profecia ka të bëjë me atë që pikërisht diskutohet, atëherë është momenti i duhur. Për shembull, nëse dikush dëshmon për shërimin e tij nga alkoolizmi, dhe fjala e pranuar nga Zotëria flet pikërisht për këtë, atëherë momenti është i volitshëm dhe duhet thënë fjalën. Zotërisë mund t’i drejtohem në këtë mënyrë: “Zotëri, më nxit që ta them atëherë kur ti dëshiron: bën që në këtë ta ndiej dorën tënde udhëheqëse.” Me atë rast frymëzim i Shpirtit Shenjt është dhurata e urtisë nëpërmes të cilës ndjejmë se si Zotëria na bën që diçka të themi ose në momentin e duhur që diçka të bëjmë. Urtia është dhuratë që duhet shfrytëzuar së bashku me profecinë që të mund ta dimë se kur duhet thënë profecinë. Ajo është dhuratë kyçe që shkon së bashku me çdo dhuratë tjetër.

Pasi që të thuhet fjalët profetike, duhet kushtuar kujdes të veçantë reagimeve tona të ardhshme individuale dhe të përbashkëta. Në rastin më të mirë, do të duheshin incizuar. Shumë bashkësi lutjesh i incizojnë profecitë në kasetofon ose e kanë personin e ngarkuar për shënime stenografike. Personalisht, konsideroj se ato profeci duhet dhënë dikujt, i cili i është përkushtuar lutjes, që të lutet mbi to dhe ajo të jetë detyra e tij e vazhdueshme. Gjatë lutjes, kur ai person të jetë hapur për të dëgjuar se çka flet zotëria, zbulesën dhe mendimet e tij të ndara do të duhej t’ua përcjellë udhëheqësve. Këtë nuk mund ta kërkoni nga shumë vetë, por gjithsesi do të mund të gjendet dikush, i cili është i hapur për lutjen e

ndërmjetësimit. Ai person mund ta lexojë profecinë, mund të përpiqet që vërtet të dëgjojë se çka Zotëria i thotë bashkësisë, mund të lutet për atë qëllim dhe të gjitha këto t'i diskutojë me udhëheqësit. Kjo është detyrë e vazhdueshme, sidomos për vikend kur nuk mund të bëjë shumicën e punëve të tjera: nëse për shembull kalon shumë kohë në lutjen personale. Është fjala për shërbesë shumë të fuqishme, sepse disa bashkësi lutjesh rritjen e vet ia kanë borxh dëgjesës së asaj që Zotëria u thotë nëpërmes të profecisë. Në rastin e kundërt, nëse një bashkësi nuk dëgjon se çka flet Zotëria, nuk e shqyrton atë ose nuk është e dëgjueshme, vërtet nuk mund të presim që Zotëria ta bekojë, sepse bashkësia e shpërfill Atë. Prandaj reagimi ynë është po ashtu i rëndësishëm sikurse edhe momenti i volitshëm për ta thënë profecinë.

## **10. Vërtetoni profecinë e të tjerëve, nëse edhe ju merrni të njëjtën porosi në zemrën tuaj, ose e keni marrë gjatë leximit të Shkrimit Shenjt**

*Duani njëri – tjetrin sikurse unë ju desha juve, duani edhe ju njëri – tjetrin!*  
(Gjn 13, 34)

Në ecjen tonë shpirtërore kurrë nuk ka mjaft trimërim të ndërsjellë, sepse shpirtërorja nuk është e prekshme. Të gjitha mund t'i shohim vetëm në mënyrë indirekte. Për këtë arsye, dhuratat tona karizmatike kërkojnë vërtetim, si në ecjen tonë të krishterë, ashtu edhe në mbarë jetën tonë të krishterë. Më duket se sa do gjatë që të veprojmë në lëmin e dhuratave karizmatike, gjithmonë do të rritemi në besim, kurse vërtetimi dhe pranimi i bashkësisë së krishterë, derisa shërbehemi me ato dhurata, gjithmonë do të jetë ndihmë dhe mbështetje, duke u bërë e dukshme në harmoni me frymëzimet e Shpirtit. Derisa shërbehemi me dhuratat e Shpirtit Shenjt, miratimi i miqve të besueshëm është “rezonator” shpirtëror, i cili është i nevojshëm për të gjithë ne që të mund të vazhdojmë më tutje. Kemi nevojë të dëgjojmë që njerëzit e miratojnë dhe e trimërojnë punën tonë, dhe vetë neve.

Kur dikush në takimin e lutjes profetizon, ata të cilët mund të vërtetojnë fjalën e pranuar, do të duhej të thonë: “E vërtetoj këtë”, që do të thotë se e kanë pranuar të njëjtën porosi prej Zotërisë. Disa do ta vërtetojnë nëpërmes të fjalëve të cituara të Shkrimeve, ose nëse ka shumë njerëz të cilët mund të vërtetojnë nëpërmes të Shkrimeve, duhet thënë: “E vërtetojmë këtë nëpërmes të Shkrimeve!” Dhe të ceket teksti i caktuar biblik. Nganjëherë mund të ndodhë që gjysma e bashkësisë mund ta vërtetojë fjalën profetike, por pas një ose dy vërtetimesh, të tjerët heshtin sepse konsiderojnë se janë thënë mjaft miratime. Sa bekim i madh për ndërtimin e mbarë bashkësisë do të ishte sikur të dëgjosh se si Zotëria i ka folur zemrës së shumicës në të njëjtën mënyrë! Nëse njëzet vetë thonë: “E vërtetojmë këtë!”, thellohet vetëdija e bashkësisë se Zotëria është vërtet i pranishëm në mesin e tyre, sikurse edhe besueshmëria se kjo vërtet vjen nga Zotëria, e sidomos nga ai i cili e ka thënë fjalën profetike. Miratimi i dhuratave shpirtërore të të tjerëve kurrë nuk është i mjaftueshëm. Në atë mënyrë ne ju tregojmë dashurinë dhe pranimin tonë.

## **11. PROFECIA**

### **(Burimore “PROPHECY”)**

“Populli im, po i përgatis zemrat tuaja që të më pranoni.”

“Populli im, dijani se ju dua dhe ju bashkoj që të mund t’ju ndihmoj. Dijani se po ju bashkoj më së shumti për arsyen që Shpirti Im të veprojë në zemrat tuaja. Shpirti im do të lëvizë fuqishëm në zemrat tuaja, që ta dini se ajo ndodhë *“jo me forcë, por me Shpirtin tim.”*



Dijeni se pa mua nuk mund të bëni asgjë. Jini të hapur për Shpirtin tim, i cili dëshiron që të shërbehet me ju më shumë se sa mund të luteni dhe të imagjinoni. Jini të hapur për veprimin e Shpirtit tim. Dijeni se po ju ngrit në tjetër nivel. Ju ftoj që t'i lëshoheni bekimit tim, prekjës sime, shërimit dhe mbushjes me jetën time.

(Vërejtje e përkthyesit: pasi që është e pamundur që të arrihet përputhshmëria në mes të shkronjave fillestare në gjuhën shqipe dhe angleze, në përkthim do ta anashkalojmë këtë, duke sjellë, megjithatë, fjalën burimore angleze për shkak të qartësisë.)

“P” Profecia na i zbulon mendimet Hyjnore

“R” Rregullisht vërehet te çdo i krishterë që është i hapur.

“O” (“OTHERS” =të tjerët) Dhuratë për të tjerët, për ndërtimin e trupit të Krishtit.

“P” Pali i ka nxitur Korintasit që të profetizojnë, por me rregull.

“H” (“HEART”=zemra) Shpirti Shenjt i flet zemrës jo kokës.

“E” (“EFFECTIVE”-veprues) Sjell ndjenjën e pranisë së Shpirtit dhe dashurisë së Zotërisë.

“C” (“CONTROL”=kontrolli) Kontrolli i folësit.

“Y” (“YOU”=ti) Duhet të sjellësh fryt të mirë.

Në këtë kapitull, duke i marrë për bazë shkronjat e fjalës profeci (prophecy) do të flasim për pikat themelore të përmendura më lart. Me këtë përmbledhje mund të shërbehen udhëheqësit e bashkësive të lutjes si me një drejtuese për mësim, të cilin, natyrisht do ta pasurojnë me stilin personal të mësimin.

*“Secili merr dhuratë të veçantë të zbulesës së Shpirtit Shenjt për të mirën e përbashkët.(...) E të gjitha këto i bën një i vetmi Shpirt shenjt duke i ndarë veçanërisht secilit ashtu si Ai do.”* (1 Kor 12,7;11) Ai secilit i jep tjetër dhuratë, të veçantë për shërbesë. Në një person do të jetë e dukshme një dhuratë e Shpirtit më shumë se një tjetër, por mundësia e shfrytëzimit të nëntë dhuratave ekziston tek të gjithë, sepse Shpirti Shenjt banon në ne. Kur i drejtohem Zotërisë duke u lutur në gjuhë, kur e madhërojmë, Ai do të në përgjigjet. Kjo është një shpresë krejtësisht e arsyeshme – që të presësh përgjigje nga dikush të cilit i jemi drejtuar.

“P”

Profecia na i zbulon mendimet hyjnore. Çka Zotëria dëshiron në këtë çast ta porosinë bashkësinë ose neve personalisht? Kur e lavdërojmë, ai shpesh herë na njofton për dëshirat e veta nëpërmes të profetëve. Na flet nëpërmes të ndonjë personi. Në një rast Moisiu ka thënë: “Eh, po të ishte e mundur që i tërë populli të profetizojë e Zoti t’ia jepte Shpirtin e vet!” (Nr 11,29) Kjo, megjithatë, në kohën e Moisiut nuk ka ndodhur, por “në kohën e tanishme” të Besëlidhjes së re Shpirti Shenjt banon në ne, dhe të gjithë munden, madje do të duhej, ta bartin porosinë e tij, po qe se i hapen dhe e pranojnë shugurimin.

“R”

Profecia rregullisht ndodh. Shën Pali thotë: *“Dëshiroj që të gjithë ju të flisni në gjuhë të ndryshme, por më tepër dëshiroj të profetizoni”* (1 Kor 14,5) Disa thonë se kjo është vetëm një dëshirë e devotshme e Palit dhe se ai nuk ka pritur që të realizohet, por ai thotë: *“Dëshironi edhe dhuratat e Shpirtit Shenjt, sidomos atë të profecisë”* (1 Kor 14, 1) Ai shkruan më tej edhe këtë *“Prandaj, o vëllezër (të mi) , dëshironi dhuratën e profecisë.”* (1 Kor 14, 39) Prandaj, në se Shën Pali na nxit që të dëshirojmë të profetizojmë, sigurisht se jemi të aftë të gjithë për këtë dhe mundësia e profetizimit duhet të jetë në të gjithë. Dhurata ekziston në secilin që ka pranuar pagëzimin në Shpirtit Shenjt.

Kur luteni me njerëzit për shërim, njëra prej gjërave më të fuqishme që mund të bëni është që të lutni Zotërinë për fjalën e veçantë profetike pikërisht për atë person. Shërbehuni

me të gjitha dhuratat përnjëherë duke përdorur dy ose tri njëherazi. Thuani: “Zotëri, drejtoja tani këtij personi fjalën tënde.” Kjo do të duhej të ishte krejt normale, sepse Zotëria e do atë person më shumë se ti dhe dëshiron që t’i flasë më shumë se ti.

### “O”

Profecia është dhuratë për të tjerët, për ndërtimin e Kishës – Trupit të Krishtit. “Sepse, ai që flet gjuhë të huaj, edukon veten, kurse ai që profetizon, edukon Kishën.” (krah 1 Kor 14, 4) Profecia me të vërtetë është e nevojshme për ndërtimin e Kishës. Njëra prej përvojave të mia të para karizmatike ka qenë kur kam dëgjuar një motër që ka profetizuar në takimin e lutjes në Universitetin Loyola në New Orleans më 1969.

Sipas gjase, njëri prej projekteve më të mëdha karizmatike shoqërore në Amerikë është ai i Atë Rick Thomas në El Paso përkatësisht Juarez. Shpirti vepron fuqishëm në atë bashkësi, kurse, sipas përvojës sime dhe asaj që unë kuptoj, një pjesë e suksesit të bashkësisë i përshkruhet reagimit të bashkësisë në fjalët profetike të thëna atje. Kjo është diçka e jashtëzakonshme dhe është shembull për të gjithë se si mund të ndjekim profecitë. Natyrisht, profecia e tyre është vërtetuar më parë në shumë mënyra të ndryshme, para se të fillojnë të veprojnë në harmoni me të. Profecia, gjithmonë, vërtetohet nëpërmes Shkrimeve, nëpërmes profecive tjera, nëpërmes dëshirave të mbjella në zemrat tona, sikurse edhe nëpërmes mësimit, por duhet të jemi të hapur dëgjimit dhe pastaj të reagojmë. Nëse dikush ka thënë: “Kështu thotë Zotëria”, këtë nuk mund ta shpërfillim! Pajtohem me këtë dhe besoj se vërtet është ashtu.

### “P”

Pali në të gjitha letrat e tij flet për jetën e krishterë, e cila e nënkupton rregullisht edhe profecinë. Në shumë vende flet përmbi shfrytëzimin e lirë të dhuratave, por me rregull. Askund nuk thotë se Korintasit nuk do të duhej t’i përdorin dhuratat. Duke ju falënderuar përvojës së Shën Palit, kuptojmë se kjo është pjesë e zakonshme e jetës së krishterë, kështu që përvojën tonë mund ta ndërtojmë mbi të tijën.

### “H” (“HEART” = zemra)

Zotëria e vë porosinë në ZEMRËN tonë. Porositë e Zotërisë i pranojmë në zemër. Me atë rast, porosia është gjithmonë në vetën e parë ose të dytë: “Të dua, populli im” ose “Ju jeni të zgjedhurit e mi.” Profecia e vërtetë kurrë nuk vjen në vetën e tretë, si: “Zoti është i madh e i fuqishëm”. Ne pranojmë atë që Zotëria në atë moment mendon, atë që ka në zemër, kurse ne i themi fjalët e tij. Ai me dëshirë do t’i flasë dikujt, i cili atë do t’ia përcjellë bashkësisë. Nuk është fjala për diçka që mendohet: ajo vjen nga zemra. E jepni veten fjalës së dëgjuar. Madje, edhe nëse dëgjoni vetëm një fjalë - thoni atë! Nganjëherë ndodh që të dëgjoni dy ose më shumë fjalë – thojini ato! Në fillim profecia më vjen si një ose dy fjalë. Pasi t’i them - rrjedhin të tjerat. Vetëm një gjë është me rëndësi; që t’i jepemi Shpirtit që është në ne.

### “E” (“EFFECTIVE”= vepruese)

Profecia është efektive, sepse na shpie fuqishëm në praninë e Zotit dhe bën që të jemi të hapur për dashurinë e tij. Të gjitha dhuratat, para së gjithash, sjellin një shërim të thellë të brendshëm, e pastaj si dhuratë një ndjenjë të thellë të pranisë së Zotërisë. Kur përdoren dhuratat gjithmonë është e pranishme ndjenja e paqes, gëzimit, afërsisë së

Zotërisë, madje edhe siguria e plotë dhe besimi në Zotërinë, që janë shenja të shfaqjes së Shpirtit Shenjt.

“C” (“CONTROL”= kontrolli)

Fjalët e profetit janë gjithmonë nën kontrollin e tij. Njerëzit nganjëherë thonë: “Kam frikë se në meshën e së Dielës do të ngrihem dhe do të them diçka që do t’i shqetësojë të pranishmit.” Mirëpo, nuk është ashtu. Ju gjithmonë e keni kontrollin, sepse profecia nuk e përjashton të zotëruarit e vetes. Zotëria kurrë nuk do t’ju vente në zemër diçka që do të nxiste turbullimin ose pakënaqësinë,(...) *sepse Hyu nuk është shkaktues shrregullimesh, por i paqes.* (1 Kor 14,33)

“Y” (“YOU”= ti)

Ju duhet të sillni frytet e mira, e këtë e bëni duke bashkëpunuar me Shpirtin Shenjt. Në librin e vet *Urtia i flet fëmijëve të vet* Atë John Randall thotë se konsideron se Kisha nuk e ka kërkuar urtinë e Zotërisë aq sa është dashur, prandaj edhe frytet që i sjellim nuk janë aq të mëdha, aq sa kanë mundur të jenë. Kjo është një e vërtetë e madhe. Do të doja që famullitë t’i vlerësojnë dhe kultivojnë takimet e lutjes së paku aq sa i vlerësojnë dhe kënaqen në lojërat e fatit.

## **Kapitulli i pestë**

### **Intervista në temën e dhuratës së profecisë**

Pasojnë intervistat me

dr. Bill Mitchell, mjek familjar nga Covingtoni, LA;

zonja Priscilla Andonie, motër medicinave nga New Orleansi, LA;

zonja Elizabeth Shelton, udhëheqëse e bashkësisë së lutjes nga New Orleansi, LA;

Atë Robert DeGrandis, S.S.J., nga New Orleansi, LA, dhe

të tjerë miq.

Atë DeGrandis: Bill, ku ke qenë kur e ke thënë profecinë tënde të parë?

Bill: Kam qenë në meshë dhe në takimin e lutjes në kishën e Shën. Benildës në New Orleans. Kur u nisa për t’u kunguar, zemra filloi të më rrahë fort. Pyesja veten, çka mund të jetë kjo, por më vonë u qetësua. Pas kungimit zakonisht lexohen pjesë nga Shkrimi Shenjt ose thuhet fjalë profetike. Kur u ktheva në ulëse, fillova të lutem, dhe zemra filloi përsëri të më rrahë fuqishëm. Ishte vërtet fuqishëm, dhe citati nga Ungjillit sipas Gjonit (13,34) pandërprerë më vinte në mendje. Kjo vazhdoi derisa u ngrita. Kur e bëra këtë, të rrahurat e zemrës u qetësuan pak. Sa më shumë që i afrohesha altarit, zemra më qetësohej më shumë, më në fund arrita atje. Zakonisht është pikërisht e kundërta: sa më shumë që i afrohesha mikrofonit, zemra të rrahë më fort. Me të arritur zemra ende më rrihte më shpejt. Pikërisht në atë çast Atë Cohen thoshte profecinë. Pastaj më shikojë. Kur më dha shenjë, u drejtova kah mikrofoni - edhe disa hapa përpara - atëherë zemra mu qetësua plotësisht, dhe lexova pjesën nga Shkrimet si profeci.

Atë DeGrandis: Atë kujtohet teksti, Bill?

Bill: Po, Gjoni 13,34: “Po ju jap një urdhër të ri: Dojeni njëri-tjetrin! Sikurse unë ju desha juve, duani edhe ju njëri tjetrin!”

Atë DeGrandis: A të kujtohet profecia tjetër? Kur ka ndodhë?

Bill: Një kohë të gjitha porositë profetike kanë qenë në formë të citateve nga Shkrimet. Zotëria më jepte ndonjë citat nga Shkrimet. Një herë kisha lexuar një libër që e ka shkruar një pjesëtar i Shoqatës së afaristëve të Ungjillit të tërësishëm. Pasi që lexova përvojën e tij me fjalën profetike, fjalën e njohjes dhe fjalën e urtisë, rregullisht pranoja profeci. Kjo më ngjante kryesisht pas kungimit, kur qetësohesha krejtësisht atëherë i pranoja.

Atë DeGrandis: A të kujtohet ndonjë prej profecive të para?

Bill: Shumica e profecive që m'i jep Zotëria, flasin për dashurinë, dhe nëpërmes meje jep porosi dashurie. Ato shpesh fillojnë me fjalët "Fëmijët e mi" apo "Populli im" – kryesisht vetëm kjo. Porosia pastaj kryesisht ka të bëjë me dashurinë e tij karshi popullit të vet, e pastaj pason porosia e veçantë, konkrete.

Atë DeGrandis: A mund të na japësh ndonjë shembull?

Bill: Për shembull, pikërisht profecia që kam thënë sot në meshë është tipike.

Atë DeGrandis: A mund të na e përsëritësh?

Bill: "Populli im, të dua. Të dua më shumë se sa mund ta imagjinosh në ëndrrat më të guximshme. Shko dhe shpalle fjalën time dhe unë do të jem me ty. Kur ta kesh shpallur fjalën time dhe veprat e mrekullueshme që t'i kam bërë ty dhe atyre rreth teje, do të të përcjellin shenjat dhe mrekullitë. Të dua. Të dua. Të dua."

Si ndjehesh kur e thua profecinë?

Bill: Zakonisht zemra më rrah fort dhe më përfshin euforia. Nuk dua të them se më "kaplon Shpirti", por shqetësimi rritet deri në një kufi të caktuar, dhe kur profecia mbaron, përsëri qetësohem.

Atë DeGrandis: Do të ta bëja një sfidë, pasi që je mjek. Çka do të thoshe, nëse dikush do të thoshte se ti këto i imagjinon? Si do të përgjigjeshe?

Bill: E di se nuk ma bën këtë pyetje si meshtar! 'Njeriu i rëndomtë' mund të ketë vështirësi në pranimin e porosive shpirtërore, kurse njerëzit shpirtërorë i pranojnë porositë shpirtërore me lehtësi. Njerëzit e zakonshëm nuk i pranojnë porositë shpirtërore apo ndoshta nuk dinë t'i pranojnë.

Atë DeGrandis: Ka shumë punëtorë shëndetëso, të cilët po të dëgjonin do të thoshin: "Ai vetë i mendon. Këto nuk janë prej Zotërisë." Është interesante të rrahurit e shpejtuar dhe të fortë të zemrës që zvogëlohet kur përgatitesh që të thuash profecinë. A nuk është kështu?

Bill: Tek unë së pari paraqitet të shpejtuarit e rrahjes së zemrës. Jo gjithmonë por kryesisht. Por kur filloj ta them porosinë profetike, të rrahurat ngadalësohen.

Atë DeGrandis: Ti, si mjek, çka do t'u thoshe njerëzve të cilët thonë se duart u nxehen ose kanë ndjenjë e dashurisë së Zotit apo ngrohtësi që ju kalon nëpër trup, apo ju mpihen gishtërinjtë e këmbëve? Çka mund të thuash për këtë nga këndvështrimi mjekësor? A mund të konsiderohen këto shenja simptomatike për personat që profetizojnë apo që përgatiten që të thonë profecinë?

Bill: Kjo është e mundur si pasojë e lirit të adrenalinit. Kam qenë dëshmitar i shumë gjërave mbinatyrore. Mund të takoni personin me ritëm të shpejtuar të të rrahurave të zemrës, tek i cili adrenalina është ose nuk është e ngritur. Zotëria mund të shpejtojë rrahjen e zemrës aq sa dëshiron, nëse do që porosia e tij të përcillet. Kur të dëshirojë mund t'ju japë ndjenjën e ngrohtësisë, që të njihni shugurimin e tij. Ai është Krijues e ne jemi vetëm krijesa.

Atë DeGrandis: A pohon se e pranon shugurimin pa kurrfarë ngjarjesh përcjellëse në trup si shkak apo pasojë?

Bill: Natyrisht! Zoti është ai që i ka vendosur të gjitha ligjet e natyrës dhe mund t'i heqë kur të dëshirojë.

Atë DeGrandis: A mund të themi, atëherë, se kur pranojmë shugurimin për profetizim, suprimohen ligjet natyrore?

Bill: Është e mundur. Në vendin tim të punës, shoh shumë gjëra të tilla. Zoti bën mrekulli çdo sekondë në jetën e shumë njerëzve, vetëm se ne nuk i vërejmë dhe nuk i vlerësojmë si të tilla. Kjo do të mund të ishte e përhershme sikur të ndaleshim dhe të pyesnim Zotërinë: “Zotëri, cila është fjala jote për mua në këtë moment? Nëse ia jepni vetëm disa sekonda, do t’ua thotë menjëherë. Ta provojmë!

Atë DeGrandis: Priscilla, na thuaj diçka mbi profetizimin tënd të parë.

Priscilla: Zotëria tha se dëshiron që njerëzit të shkojnë te ai, sepse është *Zot*, dhe jo për shkak të dhuratave të cilat do të mund t’i jepte: pra, për shkak se *Ai është*.

Atë DeGrandis: Në çfarë mënyre e ke ndjerë praninë e Zotit?

Priscilla: Po përiqem ta kujtoj. E di se atë natë është thënë edhe një profeci me të cilën ajo imja ka qenë e vërtetuar. U ula pranë një zotëriu në bankën e parë dhe ia përsërita profecinë, dhe ai tha: “Mirë, dëshiroj që ta thuash sepse ke pranuar shugurimin.” Nuk mund të kujtohem saktësisht se si jam ndjerë përveç se kisha frikë. Të rrahurat e zemrës kanë qenë të njëjta pas thënies së profecisë, sikurse edhe përpara. Në të vërtetë, tani edhe nuk kam më ndryshime fizike, por në mënyrë të thjeshtë e di.

Atë DeGrandis: Fillestarët gati gjithmonë pranojnë shugurimin. Ai nganjëherë humbet me kohë, dhe mbetet vetëm feja e pastër.

Një mik: Priscilla, a e ke pranuar profetizimin e parë në formën e vizionit, fjalës apo të ndjenjës së asaj që Zotëria flet?

Priscilla: Në formën e ndjenjës. Gjithmonë është ndjenjë, më shumë se sa fjalë. Nganjëherë pranoj vizion, kurse nganjëherë vetëm fjalë. Në kohën e fundit pranoj këngë. Fjala e Zotërisë më vjen në këngë. Në kohën më të re nuk kam pranuar përveç në shtëpi, por besoj se disa nga ato këngë do të shfrytëzohen për shërim të brendshëm. Nganjëherë kur lutem me njerëz, Zotëria më jep pikërisht këngën.

Atë DeGrandis: Kjo është e mrekullueshme. Profetizim personal për personin që lutesh – në formë të këngës! E mrekullueshme!

Një mik: Më kujtohet se kisha të rrahura të shpejtuara të zemrës por nuk reagoja në to sikurse në shugurim.

Bill: Dhe nuk janë ngadalësuar?

Një mik: Nuk më kujtohet më.

Bill: Të parën herë kur kam ndjerë të rrahura më të shpejta të zemrës, kanë zgjatur shumë. Që nga çasti kur kam dalë prej kishës në New Orleans, derisa kam arritur në Covington, LA. Kanë zgjatur shumë. Pastaj lajmëroheshin, dhe dobësoheshin me afrimin e kohës kur duhej thënë profecinë.

Atë DeGrandis: Liz, a mund të kujtosh disa nga profecitë tua të para?

Liz: Profecia e parë ka qenë personale, për mua. Më kujtohet bashkësia e lutjes në të cilën kam qenë atëherë. Atë ditë të gjithë kanë dëshmuar për dhuratat që kanë pranuar, kurse unë nuk kisha pranuar asgjë. Më kujtohet se si rrija, lutesha dhe i ankohesha Zotërisë: “Mjera unë, mjera unë!”, dhe pastaj më ranë në mend fjalët nga Letra e parë e Pjetrit: “*Fis i zgjedhur, meshtari mbretërore, komb i shenjtë, popull që Hyu e fitoi për vete, për t’i shpallur veprat e madhërueshme të Atij që ju thirri nga errësira në dritën e vet të mrekullueshme. Ju që dikur nuk ishit popull e tani jeni popull i Hyut, ju që dikur ishit të përjashtuar nga mëshira, e që tani e keni fituar mëshirën.*” (1Pt 2 9-10)

Atëherë nuk kuptoja se ç’do të thotë *fis i zgjedhur* dhe *meshtari mbretërore*. Nuk më kujtohen saktësisht të gjitha, por kur pranova kapitullin dhe rreshtin, thjeshtë e thash atë, dhe pastaj vazhdova të këndoj një melodi. Melodia lindi në mua, dhe kur e hapa gojën ajo doli me lehtësi, ende jo me fjalë. Pas një kohe erdhën edhe fjalët: “Fëmija im, të dua.” Nuk e dija se është profeci. Mendoja se kjo është një këngë e bukur. Në atë kohë kisha shumë. Më kujtohet kur për herë të parë u ngrita në lutje – Zoti më jepte melodinë, dhe pastaj

trimëroheshja që të flas; melodia vinte çdo herë kur e hapja gojën e pastaj Ai më jepte edhe fjalët përcjellëse. Pastaj erdhi koha kur nuk kishte as melodi as fjalë. M'i mori të gjithë mbështetësit që të mund të jepem vetëm në besim. Tani kur ndiej nxitjen nga Zotëria për profetizim, e hap gojën, kurse melodia dhe fjalët vijnë vetë.

Atë DeGrandis: Mrekulli! A të kujtohen fjalët e ndonjërës prej profecive të para që ia ke drejtuar bashkësisë?

Liz: Do të lutem për një çast dhe do të provoj të kujtohem. Sot i kuptoj ato fjalë shumë më mirë se atëherë kur mi ka dhënë.

Atë DeGrandis: Kur ka ndodhur?

Liz: Në vitin 1973. Sot Zotëria na flet shumë shpesh për zemrën. Sot vërtet e kuptoj se për t'u shëruar dhe ndërruar, na duhet ndryshimi i zemrës. Kur të ndodh kjo, do të ndërrohen edhe mendimet dhe qëndrimet dhe do të bëhen në masë më të madhe kristocentrike, kurse ne do të jemi të ngjashëm me Krishtin. (Liz fillojë këtu të këndojë profecinë e vet të parë, ashtu si e ka mbajtur në mend.) “ Ma hapni zemrën tuaj. M'i hapni dyert dhe dritaret e zemrës suaj. M'i hapni dyert dhe dritaret e zemrës suaj dhe do t'ju mbush me dashuri, gëzim dhe paqe. M'i hapni zemrat tuaja, sepse ju dua ashtu si jeni. Mos keni frikë! Jo, mos u frikoni, sepse Ati juaj ju do.”

Me dëshirë do t'ju tregoj edhe diçka: Prishilla tha se Zoti do t'ju jep profeci për njerëzit kur të luteni për ta. Shumë shpesh derisa thoni profecinë, njerëzit marrin shumë më tepër se fjalët, sepse nëpër fjalët e profecisë zbulohet nevoja e vërtetë e njeriut për të cilin është fjala.

Një mik: Liz, çfarë qëndrimi ke ndaj dhuratës së profecisë, si udhëheqëse e bashkësisë së lutjes?

Liz: Në bashkësi kemi udhëzime mbi dhuratën e profecisë. Kur mendoj tani, në fillim nuk kemi pranuar këshilla sepse ishim fillestar, por tani i pranojmë, dhe në bashkësi ka shumë më tepër dhurata, sidomos dhurata të dallimit. Kur një numër më i vogël i anëtarëve takohet në lutje për nevojat e bashkësisë, vërejmë veprimin e Shpirtit Shenjt nëpërmes të dhuratës së profecisë. Njëra nga profecitë të cilën Ati na e ka përsëritur shpesh është se duhet që t'i shqyrtojmë profecitë e pranuar sepse shpesh mund të humbasin ato që janë pranuar në takimin e lutjes. Na fton që t'i shënojmë fjalët profetike, ashtu që mos të humbasin ato që na i thotë në takimet tona të lutjes.

Bill: A i incizoni takimet e lutjes?

Liz: Po, por edhe marrim shënime.

Kur jemi lutur pas intervistës, Zotëria na foli kështu, nëpërmes dhuratës së profecisë:

Po e forcoj besimin tuaj në një nivel më të lartë, më të lartë se ka qenë deri tani;

Gjithmonë jam me ju. Ejani pushoni në mua. Unë do të jem pushimi juaj;

Ju ftoj që të niseni kah fuqia e Shpirtit tim të Shenjtë dhe përhapni zjarrin tim si ungjilltar. Bartni fjalën time. Bëhuni të fortë në besim dhe mbështetuni në mua. Lejoni që fjala ime të vijë nga pjesa më e thellë e qenies suaj. E ftoj secilin nga ju që të jetë ungjilltar.

Kur të më dorëzoheni, do të shërbehem me ju fuqishëm. Kujtoni bijën time të dashur Marinë. Si ajo që ka lindur Jezusin ashtu edhe ju duhet të luteni që t'ju hijezojë Shpirti Shenjt dhe të bëjë në zemrat tuaja pushimore për mua, që të mund të trashëgoni Marinë duke më bartur në botë. Duhet të bisedoni më shumë për Marinë, sepse ajo buron nga këto Rrëshajë të reja: Maria, Shpirti Shenjt dhe Pjetri janë pjesë e valës së re të Shpirtit tim të Shenjtë. Dëshiroj që të më dorëzoheni edhe më tepër. Harroni veten dhe problemet tuaja dhe harroni se kush jeni, por mendoni se të kujt jeni. Ju ftoj në fuqinë e Shpirtit tim dhe të Fjalës sime që të më dorëzoheni. Nuk do t'ju përdor vetëm si ungjilltar, por do të shërbehem me balsamin e ëmbël të Shpirtit Shenjt që të rrjedh nëpër ju. Kështu kur të luteni dhe të bëni hapa më të mëdhenj se deri tani, Shenja dhe mrekulli do të ndodhin nëpërmes jush në këtë kohë. Kërkoj prej jush, po ashtu, që të forcoheni në besim, që ta njihni Fjalën time dhe t'i

lejoni të bëhet pjesë e juaja. Ju ftoj që ta bëni hapin në fuqinë e Fjalës, që të mund t'i bëni shenjat dhe mrekullitë e mia;

Ejani në thellësinë e zemrës sime dhe pushoni në mua, sepse po ju jap pushimin tim të së shtunës. Ejani në zemrën time sepse jam i vetmuar pa ju;

Vazhdoni në besim, me dashuri dhe guxim. Nëpër dashuri, kërkoni dhe do të fitoni.

## **Kapitulli i gjashtë**

### **Pyetje dhe përgjigje**

#### **A mund të futen në takimet e lutjeve profecitë e pranuar në shtëpi?**

Personalisht nuk do të lejoja që të futet çfarëdo qoftë nga jashtë. Çdo gjë që duhet të ndodhë në takim të lutjes, do të ndodhë për deri sa bashkësia ta lavdërojë. Profecitë e shkruara, ëndrrat dhe frymëzimet jashtë takimit të lutjes, nuk do të duhej sjellë, sepse besoj që Zotëria mund të bëjë çdo gjë që dëshiron gjatë takimit të lutjes. Sjellja e profecisë nga shtëpia i lë shumë kohë personit, i cili fjalën nga Zotëria ka mundur ta pranojë në ora dy pas mesnate. Ndoshta nuk kam të drejtë, por jam shumë më i kënaqur me profecinë që vjen në çastin kur bashkësia lavdëron dhe falënderon Zotërinë, kurse Shpirti vepron në të pranishmit. Nëse je në shtëpi kur pranon profecinë mendoj se është fjala për profeci personale.

**Nëse pranoj të njëjtën fjalë të cilën posa e tha dikush, a duhet të them vetëm “E vërtetoj”, apo duhet ta them ashtu si e pranova unë?**

Profeci është fjala që thuhet. Prandaj ose thuhet: “E vërtetoj” ose përsëritet fjala e pranuar, me kusht që të mos jetë tepër e gjatë.

**A duhet që t'i them ndonjë gjë personit për fjalën të cilën e ka pranuar nga Zotëria?**

Gjithsesi. Nëse ju kanë prekur fjalët që i ka thënë personi duhet të thuash: “Kjo profeci vërtet më ka prekur!” Kjo gjë do ta ndërtojë dhe do t'i ofrojë vetëbesim. Duhet që t'i njohim dhe t'i pranojmë dhuratat që Zotëria na jep. Madje edhe unë, në shërbesën time të shërimit, jam i befasuar, nganjëherë, me sherimet që ndodhin. Ju ndoshta thoni se nuk do duhej që të çuditem por unë, megjithatë, çuditem, sepse njeriu gjithmonë dyshon në vete. Probleme tona të shumta rrjedhin pikërisht, jo për shkak të dyshimit në Zotërinë por për shkak të dyshimit në veten tonë. Dyshimi në veten tonë vërtet mund të jetë shkatërrues për jetën tonë shpirtërore.

#### **Çfarë mund të thuhet për poezinë apo prozën fetare?**

Kujtohu se çka kam thënë për sjelljen e çfarëdo gjëje qoftë nga jashtë në bashkësinë e lutjes! Nuk dua të them me këtë se ajo që ke shkruar nuk është nga Zotëria. Por, rreziku është shumë më i vogël që të lejohen vetëm ato që ndodhin në takimin e lutjes.

**Nganjëherë Zotëria më flet për mua ose për dikënd tjetër shumë gjatë. Këtë më duhet ta shkruaj, sepse nuk mund ta them, ashtu thjeshtë, si disa të tjerë.**

Nëse është fjala për profeci personale, në mënyrë të thjeshtë, dorëzoja personit që i dedikohet. Profecinë personale nuk do ta thosha për tërë bashkësisë. Është krejtësisht në rregull që në mënyrë të shkruar t'i dorëzohet personit profecia që ka të bëjë me të.

**A është e gabuar që të kërkohet lavdërimi apo të pyeten të tjerët: “Si ka tingëlluar kjo? A të ka prekur në zemër?”**

Nuk është gabim, përkundrazi, është shumë mirë. Do duhej që ta vërtetosh te ata që e kanë dhuratën e profecisë dhe t'i pyesësh për shqyrtimin e dhuratës sate. Po ashtu mund

ta pyesësh edhe udhëheqësin e bashkësisë së lutjes. Nuk duhet të jesh i padurueshëm tej mase, por, nëse në çastin kur e pranove fjalën profetike, shugurimi që i dobët dhe nuk ishe krejtësisht i sigurt, atëherë duhet vërtetuar. Pasi ta thuash profecinë, dëgjo reagimet e të tjerëve. Ato do të jenë kryesisht pozitive dhe ti do të jesh i sigurt se çdo gjë është në rregull. E gjithë kjo do të të ndihmojë që në të ardhmen të hapesh edhe më tepër, dhe të jesh i disponuar, po ashtu, edhe për përmirësime. Shko pas dhuratës sate duke pritur dallimin nga të tjerët.

**Çfarë duhet të bëj nëse dikush në bashkësinë e lutjes thotë profeci e cila më duket se nuk është nga Zotëria?**

Profecitë janë tri llojesh: Profecia e vërtetë, joprofecia (fjalë e mirë dhe e devotshme) dhe profecia e rreme. Për joprofecinë mund të ndjeni se nuk është nga Zotëria sepse ndjehet një zhgënjim i caktuar, derisa nga Zotëria pritet vrulli i dhuruar. Për joprofecinë duhet të kenë kujdes udhëheqësit. Nuk pengon nëse kohë pas kohe kemi ndonjë joprofeci, sepse të gjithë përpiqemi, dhe brenda atyre përpjekjeve mund të ketë suksese dhe dështime. Por nëse janë të shpeshta te një person, udhëheqësit duhet të reagojnë. Nëse ndjeni se ndonjë profeci nuk është nga Zotëria, bisedoni me drejtuesit. Profecitë e rreme janë të rralla dhe do t'i njihni menjëherë sepse diçka në shpirtin tuaj do t'ju tërheqë vërejtjen.

**Nganjëherë jashtë takimit të lutjes pranoj fjalën të cilën kam dëshirë ta ndaj me bashkësinë e lutjes. A është ajo profeci?**

Së pari duhet të pyesni Zotërinë për çka është fjala. Së dyti, më duket se në bashkësinë e lutjes ekziston biseda e gjallë me Zotërinë. Pasi që bashkësia e lutjes i drejtohet Zotërisë me këngë dhe lavdërime, Ai do t'i përgjigjet në atë çast. Për mua, personalisht, kjo është koha më e mirë. Në këtë çast takohemi me Zotin e gjallë, i bashkësisë dëshiron t'i drejtojë fjalën e gjallë, që të mund të rrjedhin ujërat e gjalla. Prandaj nuk ka kuptim që të hënën në dhomën tënde të pranosh profecinë për takimin e lutjes të premtën. Nuk mund të them se kjo nuk mund të ndodh, por do të dëshiroja – dhe është më e sigurt – që profecia të realizohet në rrethin e bashkësisë së gjallë.

**Çka nëse fjalët e profecisë i pranoj gjatë vozitjes për takimin e lutjes?**

Është e mundur. Dhe përsëri, Zotëria mund të japë të njëjtën fjalë në bashkësinë e lutjes. Kur ishte e mundur, mbaja takimin e drejtuesve gjysmë ore para takimit të rregullt të lutjes. Nganjëherë ndodh që Zotëria të na japë profecinë në takimin e drejtuesve, dhe pastaj të njëjtat profeci i thonë njerëz të tjerë brenda bashkësisë së lutjes në takimin e lutjes. Si do që të jetë, kështu na përgatit për takimin e madh. Nuk duhet ta kufizojmë Zotërinë duke kujtuar se Ai mund t'i flasë Marisë derisa është në kuzhinë ose Gjonit derisa vozit automobilin. Gjithsesi është më sigurt që ta lusim Zotërinë që të na flasë në takimin e lutjes, sepse aty është e mundur shqyrtimi i bashkësisë për sa i përket fjalës profetike.

**A mund të jemi krejtësisht të sigurt se një profeci është nga Zotëria?**

Jo, vërtet nuk mundemi. Kur i themi fjalët profetike gjendemi në fushën e besimit, dhe besimi është mbështetje në gjërat që nuk i shohim. Kur kemi të bëjmë me dhuratat e Shpirtit Shenjt nuk ka siguri të plotë sikurse në matematikë, p.sh. Matematikisht e dimë se dy dhe dy nuk bëjnë gjashtë. Në lidhje me këtë kemi vërtetësinë matematikore se cila nuk është e mundur me profecinë dhe dhuratat tjera të Shpirtit Shenjt. Gjithmonë ekziston elementi i besimit, sikurse që është rasti edhe me vetë ekzistencën e Zotit. Për ekzistencën e Zotit nuk është e mundur vërtetësia matematikore. Kjo është çështje besimi, që vlen edhe për dhuratat e Shpirtit Shenjt. Derisa dhuratat sjellin fryte të mira në jetën tonë dhe në jetën e të tjerëve, është trimërimi më i madh i mundshëm, si dhe e gjithë siguria që na duhet.

**Shpesh herë gjatë lutjes më vijnë fjalët e Shkrimit Shenjt të cilat më kthehen, për shembull: “Ejani te unë të gjithë ju të lodhur dhe të ngarkuar dhe unë do t’ju çlodh.” Nëse ndjejmë fjalë të ngjashme dhe nuk jemi të sigurt se a na drejtohen neve apo krejt bashkësisë, a duhet që t’i themi?**



Pyeteni Zotërinë se kujt ia drejton juve apo bashkësisë. Nëse kthehen pandërprerë atëherë ndajini me bashkësinë. Pastaj unë do të dëgjoja reagimin e saj. Nëse duket se kanë ndikim në te, në kuptimin që, p.sh. ngrisin nivelin e lavdërimit, atëherë do të kisha prirjen që të mendoj se ishin të dedikuara edhe ty edhe bashkësisë. Së pari bashkësisë e pastaj edhe juve.

**Nëse personi në zemrën e vet beson se profetizon, por, në të vërtetë, është fjala për joprofecë; a konsideroni se megjithatë duhet t'i thotë ato fjalë me shpresë se një ditë do të zhvillohen në dhuratë të vërtetë profecie?**

Po, kjo është e mundur me sjellje të drejtë të udhëheqësit. Me fjalë të tjera, nuk mund të presim përsosmëri të menjëhershme. Kur fëmija fillon të shkruajë, ai në klasën e parë nuk i formëson shkronjat si duhet, por me kohë përmirësohet gradualisht. Kështu, fëmija kur shkon në shkollë të mesme, shkruan dukshëm më mirë se sa shkruante në klasën e parë të fillores. Pra, krejt jeta është një proces, që vlen edhe për dhuratat e Shpirtit Shenjt. Fillojmë në një nivel të ulët themelor. Me kohë shpirtin tonë ia hapim më shumë e më shumë Shpirtit Shenjt, dhe bëhemi më të "kalueshëm". Shembull i mirë për këtë është dhurata e shërimeve. Në fillim ndoshta jeni lutur për shërim të kokë dhembjes, por pas pesëmbëdhjetë vitesh ndoshta do të luteni me sukses për shërimin nga kanceri. Me fjalë të tjera, në të gjitha dhuratat ekziston rritja, pikërisht sikurse të gjitha gjërat në natyrë janë çështje e rritjes organike.

Pesë vitet e para në lëvizjen karizmatike mund të konsiderohen si klasë e parë, pesë të tjerat si klasë të dytë, kurse pesëshin e tretë si klasë të tretë. Shumë prej nesh janë në klasë të tretë dhe kemi se çka të presim në të ardhmen. Me kalimin e kohës vërej se si dhuratat e njerëzve forcohen dhe bëhen përherë e më të nduarnduarshme, krahasuar me fillimin. Dhuratat kanë lulëzuar dhe do të vazhdojnë të lulëzojnë. Në Karaibe janë disa gra që jetojnë në Shpirtin Shenjt tridhjetë vjet. Një ditë para se Zotëria t'u dërgojë dikënd që t'i vizitojë ato kanë para sysh fotografinë e atij personi si në film. Supozoj se atë dhuratë nuk e kanë pasë vitin e parë kur janë pagëzuar në Shpirtin Shenjt. Vetëm Zotëria e di se çfarë dhurata të fuqishme ne kemi, por tani është çasti që të fillojmë me hapat e parë. Pikërisht për këtë edhe po flasim – për hapat e parë në besim dhe shpresë që Zotëria të na udhëheq.

**Në fillim kur profetizoja, ndieja një shugurim të fuqishëm. Tani më mundon pyetja: "A vjen kjo nga unë apo nga Zotëria?" Si ta dalloj këtë?**

Sipas gjase në fillim Zotëria është dashur që të shërbehet me presion të madh që t'i themi fjalët e Tij. Pasi je rritë te ajo dhuratë, Zotëria ta ka marrë shugurimin e ndjeshëm, prandaj tani vepron në besim. Pyetjet që duhet t'ia bësh vetes janë: A janë frytet e mira? A përputhet profecia me mësimin themelor të takimit të lutjes? Kur është fjala për personin, i cili është i kyçur në Përtëritje për një kohë më të gjatë dhe ka dhuratën e profecisë për tri ose katër vjet, mund të supozohet se është fjala për profeci të vërtetë. Ngjashëm është edhe me dhuratën e gjuhëve – nëse pas tri vitesh përvoje lutjeje në gjuhë ju më pyesni se a vërtet lutem në gjuhë, do t'ju përgjigjesha se pas tri vitesh gjasat janë shumë të mëdha që Shpirti 'ka depërtuar' dhe lirisht guxojmë të supozojmë se përgjigja në pyetje është pohuese.

Është vështirë që profecia të vlerësohet nga pikëpamja personale, çka vlen edhe për shumë lëmi tjera të jetës sonë. Dhuratat tona personale janë shumë afër nesh. Prandaj na duhen të tjerë persona të cilët do të na thonë se si i shohin dhuratat tona. Për këtë arsye ju nxis që t'u afroheni njerëzve në të cilët keni besim dhe t'i pyesni.

Në jetën shpirtërore më tepër mbështetemi në besim. Një shembull për këtë është edhe lutja – sa më tepër hyjmë në jetën shpirtërore lutja na bëhet më e vështirë dhe çdo herë e më pak ka të bëjë me ndjenja. Ekziston momenti kur pyetemi se a ekziston kjo lutje fare apo jo. Prandaj na duhet udhëheqësi shpirtëror, i cili gjithmonë do të na japë kurajë dhe do të na nxisë të qëndrojmë në lutje, sepse dyshimi në lutje është rruga nëpër të cilën

duhet të kalojë çdo i krishterë. Përherë e më shumë është fjala për përvojë besimi e jo përvojë ndjenjash. Njësoj është me dhuratat e Shpirtit Shenjt, sepse është fjala për përvojën e besimit, kështu që do të ketë më pak ndjenja e më pak shigurime. Kjo vlen sidomos për profecinë.

**Pse në disa bashkësi ka më shumë profeci e në disa më pak? A është kjo për shkak të drejtuesve?**

Mendoj se ashtu është. Nëse drejtuesit edhe vetë nuk janë të hapur për përvojën e profecisë, bashkësia e lutjes do të ketë qëndrim negativ ndaj kësaj dhurate. Drejtuesi zakonisht jep mësim të mirë për dhuratat me të cilat ka përvojë. Nëse drejtuesi nuk ka përvojë me dhuratën e profecisë, vështirë se mund të japë mësim të mirë për të. Në të vërtetë, drejtuesit që nuk kanë përvojë me një dhuratë të caktuar prirjen që të ndjejnë madje edhe frikë prej saj.

**Nganjëherë në vete pranoj një fjalë profecie, por kur flas, del diçka krejt tjetër. A është fjala atëherë për profeci?**

Nëse fjalët e thëna të befasojnë aq më tepër mund të jesh i sigurt se janë prej Zotërisë.

**Pranoj vetëm një ose dy fjalë përnjëherë. Të tjerët në bashkësi pranojnë profeci të gjatë. Më intereson, a është fjala për profeci në rastin tim?**

Ata që pranojnë me pak fjalë i fton në besim më të madh, sepse duhet të thonë një fjalë apo dy sosh që të pasojnë të tjerat. Kur me bashkësinë të ndani atë që Zotëria ka dhënë, Ai ju jep më shumë e më shumë. Ky është rasti me mua. Kryesisht i pranoj disa fjalë, por posa i përcjell, vijnë të tjerat. Kjo, në një kuptim, është shumë mirë. E di se nuk është e jotja, sepse nuk e ke idenë dhe nuk ke planifikuar se çka do të thuash. Kur fjalët vijnë, ke vërtetim shtesë se vërtet janë nga Zotëria. Ata që profetizojnë gjatë, sipas gjase kanë filluar si ti: me një fjalë ose dy. Secilën herë kur profetizon je i bekuar thellë, prandaj mos e privo veten nga ai bekim. Thuaj profecinë që ndien në zemër, dhe ajo do të jetë bekim, edhe pse do të jetë dikush që do të japë profeci më të gjatë e më të thellë.

**Si mund të rritem në dhuratën e profecisë nëse ndjej se Zotëria më fton pikërisht në këtë dhuratë? Çka mund të bëj saktësisht?**

Mund të lutesh që krenaria mos të të pengojë, sepse do pasur përvujtëri të madhe, mendjen tonë t'ia dorëzojmë Zotërisë. Së pari, lutu. Së dyti, dëshiro me gjithë zemër. Shën Pali thotë se pikërisht dëshira e madhe e hap shpirtin. Së treti, hapu. Kur ndien se po vjen, mësohu që të shërbehesh me të duke e përdorur. Është ngjashëm me pagëzimin me Shpirtin Shenjt - duhet ta dëshirosh. Kur t'i dorëzohesh Zotërisë, do të ndodhë. Nëse nuk ndodh të njëjtin moment, do të ndodhë më vonë. Do të të ndihmojë leximi i të gjithave që do të gjesh në temën e dhuratës së profecisë, si dhe biseda me ata që tanimë shërbehen me atë dhuratë.

**A është e thënë që profecia duhet të pasojë pas lutjes apo këndimit në gjuhë në takimin e lutjes?**

Nuk është e thënë. Gjatë kohës së lutjes personale kur je i hapur Zotërisë, do të ndjesh se si përherë e më shumë i flet zemrës sate. Kjo është profeci personale. Mund të të ndodh, për deri sa je duke i larë enët, e Ai të thotë: Bija ime, sot po të bekoj!, edhe pse ndoshta nuk je lutur, por ke qenë e hapur për Zotërinë. Profecia kryesisht pason pas lutjes ose këndimit në gjuhë në takimin e lutjes, nëse njerëzit janë të hapur për Zotërinë dhe i dorëzohen. Edhe pse njerëzit ndoshta nuk e thonë, profecia është gjithmonë aty sepse Zotëria ka dëshirë më të madhe të na flasë se sa që ne kemi dëshirë të na bekojë. Nuk duhet harruar se Zoti është dashuri, dhe dashuria është vetvetiu dhënie. "(... )aq më tepër Ati juaj që është në qiell do të ju japë gjëra të mira atyre që ia lypin" (Mt 7,11)

## **Kapitulli i Shtatë**

### **Dëshmi personale**

Me gjithë dëshirë do të ndaja me ju profecinë time të parë: ajo ndodhi në tubimin në Indiana në vitin 1971. Isha në shoqërinë e vëllait tim, atë. Robert de Grandis, derisa lutej për disa rregulltare. Pasi ato shkuan, i thashë se i kam pranuar “dy rreshta”. Ai u përgjigj: “vërtet? E cilët janë?” I thashë se fjalët ishin shumë të thjeshta: “Bijat e mia, mos u brengosni! Unë do ta hap derën.” “Dottie”, tha ai “Nesër në mëngjes do t’i kërkosh ato rregulltare dhe do t’ua përcjellësh fjalët që ke pranuar.” Në pyetjen time: Përse?, u përgjigj se është fjala për profeci. Mendoja se po mahitej! Për mua këto ishin punë fëmijësh, dhe kisha frikë se rregulltaret do të mendonin për mua se jam e marrë! Por ai tha: “Ti nuk mund ta marrësh me mend sa është e rëndësishme kjo gjë për to!” Më në fund, në insistimin e tij, pranova që të shkoj.

Ditëve të ardhshme i vëreja në mesin e turmës prej 10 000 njerëzish. Ua përcolla profecinë që e kisha pranuar derisa im vëlla lutej për to. Posa i thashë fjalët e profecisë, që të tri rregulltaret mu hodhën rreth qafës dhe filluan të më puthin e të më përqafojnë. Ishte e qartë se e kishin kuptuar se çka ka dashur Zotëria t’u thotë me këtë!

Vitin tjetër u ktheva në Universitetin Notre Dame. Derisa rrinim e bisedonim na u afrua një grua dhe së pari përqafojë vëllanë tim pastaj mua. Nuk e njoha. Atëherë tha se është njëra nga ato tri rregulltaret nga takimi i vitit të kaluar. E pyeta se a është realizuar profecia. Ajo pohoi. Na tregojë se në takim kishin ardhur që të kërkojnë këshillë nga Zotëria. Jetonin në kllazurë, dhe kishin ndër mend që pas kthimit nga takimi të kërkonin prej motrës kryesore lejen për të punuar me njerëzit dhe që t’ju ndihmojnë. Tha se pas kthimit vërtet kishin marrë lejen, dhe që atëherë merren me veprimtarinë e dëshiruar. Prandaj, profecia që ua kam thënë ka qenë aq e rëndësishme për to.

Çfarë do të ndodhte sikur të kisha refuzuar atë “punë fëmijësh” ta ndaja me këto tri rregulltare? Jam e sigurt se asgjë e tmerrshme, por besoj se ato, duke ju falënderuar profecisë që kanë dëgjuar, janë kthyer në shtëpi me shumë më tepër shpresë në Zotërinë, Në lidhje me shërbesën e tyre të re.

Dorothea DeGrandis Sudol  
Lowell, Massachusetts

Vërtet kam marrë bekim të madh kur jemi lutur që të fitoj dhuratën e profecisë. Njëherësh jam bekuar me dhuratën e gjuhëve dhe atë të sherimeve.

Nëpërmes lutjes dhe vizualizimit (paraqitjes, të imagjinuarit), pranova pagëzimin në Shpirtin Shenjt dhe u hapa për dhuratat. Ajo përvojë ishte jashtëzakonisht e fuqishme. Ndjehesha si në botën tjetër, larg nga hutia e kësaj bote. Isha krejtësisht e qetë dhe kisha ndjenjë të forte të afërsisë së Zotërisë.

Më kujtohet profecia ime e parë në formë të mendimeve të thjeshta, të cilat më erdhën në mendje. Para se të mendoja tanimë i kisha thënë fjalët. Zemra më rrihte aq fort sa kujtoja se po e dëgjon secili i pranishëm. Nuk mund të besoja se po i them fjalët. Për mua ishte shërim i vërtetë. Përndryshe gjithmonë kam folë me vështirësi, sidomos para shumë njerëzish. Në ndërkohë kam pranuar po ashtu edhe dhuratën e vizionit.

Tani e di se nëse dëshirojmë dhuratat, duhet të hapemi dhe të bëjmë hapin në besim, duke bashkuar sytë, veshët dhe zemrën me Zotërinë. Duhet të mohojmë frikën nga refuzimi, përqeshja, zilia si dhe nga të gjitha gjërat negative që do të mund të na pengojnë

në kryerjen e veprave të Zotit dhe shfrytëzimin e dhuratave të Tij. Të falem nderit Zotëri për dhuratën tënde të profecisë, si dhe për të gjitha dhuratat me të cilat më ke bekuar.

Muriel  
Lowell, Massachusetts

Në takimin e dytë e të tretë të lutjes në të cilët kam qenë më 1970, 'pashë' kullosë të mrekullueshme të rrethuar me mur, në të cilin ishin dyert e drunjta. Dëgjova fjalët: "Eja në kullosat e mia."

Kjo përsëritej për më shumë se një orë. Gjatë takimit të lutjes nuk thashë asnjë fjalë, sepse deri atëherë askush nuk më kishte thënë gjë për dhuratën e profecisë. Vetëm disa muaj më vonë, duke lexuar librat e Keneth Hagin mbi dhuratën e profecisë, e kuptova se, në të vërtetë, kisha përjetuar përvojën e dhuratës së profecisë.

Tani më duket se ajo ka qenë profeci personale. Zotëria më thirri në një ecje më intensive me Të.

Betty  
Lowell, Massachusetts

## ***Kapitulli i tetë***

### **Çfarë na thotë Shkrimi Shenjt për dhuratën e profecisë?**

Numrat 11, 29: "Eh, po të ishte e mundur që i tërë populli të profetizojë e zoti t'ia jepte Shpirtin e vet!"

Jeremia 1, 4-10: Fjala e Zotit më qe drejtuar e më tha: "Para se të trajtova në kraharorin amnor, të njoha e para se të dilje nga gjiri amnor, të shenjtërova, të caktova të jesh profet i popujve. Përgjigjja: "Eheu, o Zot Hyj! Po, unë nuk di të flas, sepse jam fëmijë!" Por Zoti më përgjigji Mos thuaj: 'Jam fëmijë!' Por shko te të gjithë ata që do të të dërgoj dhe thuaju gjithçka që do të të urdhëroj. Mos ki kurrfarë frike para tyre, sepse unë jam me ty për të të mbrojtur, - është fjala e Zotit. Atëherë Zoti e shtriu dorën e vet, ma preku gojën time e më tha: "Ja, unë po i vë fjalët e mia në gojën tënde. Ja, sot po të vë përmbi popuj e përmbi mbretëri, për të çrrënjësuar e për të rrënuar, për të shkatërruar e për të shpërndarë, për të ndërtuar e për të mbjellë."

Joeli 3, 1-3: "E pas këtyre: do ta ndikoj Shpirtin tim mbi çdo njeri e do të bëhen profetë bijtë e bijat tuaja, pleqtë tuaj ëndrra do të shohin, djelmoshat tuaj do të kenë vegime. Madje edhe mbi sklevër të mi – burrat e gra, në ato ditë do ta ndikoj Shpirtin tim. Do të bëjë shenja të bindshme në qiell e në tokë: gjak e zjarr e shtylla tymi! "

(gjithashtu, Veprat e Apostujve 2, 17-18)

1 Korintianëve 12, 4-11: “Dhurata janë të ndryshme, por Shpirti Shenjt është i njëjtë; edhe shërbesat në përhapje të Ungjillit janë të ndryshme, por Zoti është i njëjtë; po edhe mënyrat e veprimit janë të ndryshme, por Hyji është i njëjtë; Ai bën gjithçka në të gjithë. Secili merr dhuratë të veçantë të zbulesës së Shpirtit Shenjt për të mirën e përbashkët . Dhe njëmend, Shpirti Shenjt i jep njërit fjalën e urtisë, kurse i njëjti Shpirt Shenjt një tjetri i jep fjalën e dijes; po i njëjti Shpirt Shenjt një tjetri i jep fenë, një tjetri prapë, i njëjti Shpirt Shenjt një tjetri i jep dhuratën e shërimeve; një tjetri pushtetin për të bërë mrekulli, një tjetri profecinë, një tjetri aftësinë ti dallojë shpirtrat, një tjetri zotësinë e gjuhëve të ndryshme, një tjetri shtjellimin e gjuhëve. E të gjitha këto i bën një i vetmi shpirt shenjt dukë i ndarë veçanërisht secilit ashtu si Ai do.”

Romakëve 12, 4-6: “Sepse, sikur në një trup kemi shumë gjymtyrë dhe të gjitha gjymtyrët nuk e kanë të njëjtin funksion, kështu edhe ne, edhe pse shumë, jemi një trup i vetëm në Krishtin e, secili nesh, gjymtyrë e njeri-tjetrit. Kemi dhurata të ndryshme sipas hirit që na u dha: Në qoftë dhurata e profecisë; le të ushtrohet në përkim me fe; (...)”

Veprat e Apostujve 15, 32: “Juda e Sila, që edhe ata vetë ishin profetë, folën gjatë për tu dhënë vëllezërve zemër dhe i përforcuan.”

Veprat e Apostujve 19, 5-6: “Kur dëgjuan, u pagëzuan në Emër të Jezusit Zot, e kur Pali i vuri duart mbi ta, në të zbriti Shpirti Shenjt dhe filluan të flasin në gjuhë të ndryshme e të profetizojnë”

1 Korintianëve 12, 28-29: “Kështu Hyji disa në Kishë i caktoi: më parë apostujt, së dyti profetët, së treti mësuesit; pastaj vjen dhurata e mrekullive, pastaj ajo e shërimeve, e kujdesimit, e drejtimit shpirtëror, dhurata e gjuhëve të ndryshme.”

1 Korintianëve 13, 9: “Sepse njohuria jonë është e kufizuar dhe e kufizuar është profecia jonë.”

1 Korintianëve 14, 1-5: “Kërkoni të fitoni dashurinë. Dëshironi edhe dhuratat e Shpirtit Shenjt, sidomos atë të profecisë. Sepse, ai që flet gjuhë të huaj, flet me Hyjin e jo me njerëz: askush nuk e merr vesh, sepse me anë të Shpirtit flet sende të fshehura. Kurse ai që profetizon u flet njerëzve : edukon, qorton, ngushëllon. Ai që flet në gjuhë të huaj edukon veten, kurse ai që profetizon edukon bashkësinë. Dëshiroj që të gjithë ju të flisni në gjuhë të ndryshme, por më tepër dëshiroj që të profetizoni, sepse më i madh është ai që profetizon se ai që flet në gjuhë të ndryshme, përveç se në shtjelloftë për edukimin e Kishës. “

1 Korintianëve 14, 22-25: “Këndeje, gjuhët e huaja nuk janë shenjë për besimtarët, por janë shenjë për ata që nuk besojnë, e përkundrazi, profecia është shenjë për besimtarët, e jo për ata që nuk besojnë. Po e zëmë, se, për shembull, bashkohet mbarë kisha dhe të gjithë flasin në gjuhë të huaja e, ndërkaq hyjnë asish që s’kanë njohuri ose nuk besojnë, athua se nuk do të mendojnë se jeni marruar? Kurse në qoftë se të gjithë profetizojnë, i pafeu ose dëgjuesi i thjeshtë që hyn, për të çdo gjë bëhet qortim ose dënim. Atëherë zbulohen fshehtësitë e zemrës së tij. Kështu ai do të bjerë përmbys dhe do ta adhuroj Hyjin duke pranuar : >Hyji është më të vërtetë midis jush!<”

1 Korintianëve 14, 29-33: “ Lidhur me profetët, le të flasin dy ose tre të tjerët le të gjykojnë. Por, po qe se ai afër tij ka ndonjë zbulesë, atëherë i pari le të heshtojë. Një nga një, të gjithë mund të profetizoni, në mënyrë që të gjithë të mësojnë e të nxiten kah e mira.

Profetët zotërojnë me shpirtin frymëzues të vetin, sepse Hyji nuk është shkaktues shrrëgullimesh, por i paqes.”

1 Korintianëve 14, 39-40: “Prandaj, o vëllezër (të mi), dëshironi dhuratën e profecisë, por mos pengoni të flasin në gjuhë të huaja, e gjithçka le të bëhet në mënyrë të ndershme e rregullisht.”

1 Efesianëve 4, 11-13: “E Ai i ‘dha’ disa apostuj, disa tjerë profetë, disa prapë ungjilltarë, do të tjerë barinj dhe mësues, që shenjtërit t’i bëjë të aftë për veprën e shërbesës, për ndërtimin e trupit të Krishtit, (...)”

1 Korintianëve 13, 2: “Po ta kisha dhuratën e profecisë e t’i dija gjitha misteret e të gjitha dituritë; po ta kisha edhe fenë e plotë, me të cilën të mund t’u shndërroja vend maleve, por po të më mungonte dashuria, s’do isha asgjë!”

Selanikasve 5, 19-21: “Mos e pengoni Shpirtin Shenjt të veprojë në ju! Profecitë mos i përbuzni!” Çdo gjë shqyrtoni me kujdes: mbani të mirën!”

1 Tim 1,18: “Po ta jap këtë detyrë, biri im Timote, në përkim me profecitë që dikur u thanë mbi ty: Ti, i mbështetur në to, lufto luftën e mirë!”

1 Tim 4,14: “Mos e lë pas dore hirin që është në ty, i cili të qe dhënë në saje të profecive dhe me vënien e duarve të kolegjit të pleqve.”

2 Pj 1,19-21: “Kështu u vërtetua fjala e profetëve dhe bëni shumë mirë që mbështeteni në të si në dritën që ndriçon në vend të errët – deri të zbardhë dita e të lindë Ylli i dritës në zemrat tuaja. Para së gjithash dinie mirë këtë: asnjë parakallëxim që gjendet në Shkrim shenjt nuk mund të shpjegohet sipas trillit të kujtdo, sepse askurrë nuk ndodhi një profeci me vullnet të njeriut, por njerëzit, të frymëzuar prej Shpirtit Shenjt, folën nga ana e Hyut.

Mt 7, 15-20: “Ruajuni prej profetëve të rrejshëm, që vijnë tek ju e ju shtiren si dele, kurse përbrenda janë ujë grabitqarë. Do t’i njihni prej fryteve të tyre. Athua vilet rrushi prej ferrash ose fiqtë prej murrizash? Kështu, çdo pemë e mirë, jep fryte të mira, kurse çdo pemë e keqe jep fryte të këqija. Një pemë e mirë nuk mund të japë fryte të këqija, as një pemë e keqe nuk mund të japë fryte të mira. Çdo pemë që nuk jep fryt të mirë, pritet e qitet në zjarr. Kështu, pra, do t’i njihni profetët prej veprave të tyre.”

## Përmbledhje

Nganjëherë kemi prirjen t’i frikësohemi përvojës fetare dhe anojmë kah konservatorizmi i tepruar. Nganjëherë e kam të vështirë të veproj në shërbesën e shërimit, pikërisht për këtë arsye. Nëntëdhjetë për qind e njerëzve, mund të jetë e sigurt, se është shëruar, por këtë nuk e pranojnë. Më vonë më thonë: “Nuk jam krejt i sigurt, prandaj edhe nuk kam dëshmuar se jam shëruar.” Nëse në jetë kemi qenë të penguar për sa i përket përvojës fetare, kurse shërimi është një nga ato përvoja, atëherë kemi mëkatuar më shumë duke bërë lëshime se sa me vepër.

Për sa i përket konkretisht dhuratës së profecisë, për derisa në qetësi lutemi në gjuhë, për deri sa lusim Zotërinë që fjalët e tij t’i vë në mendjen tonë, dhe – nëse në kokë na paraqitet një fjalë, e cila nuk ishte më parë atje - supozojmë se është fjala për PROFECI: dhe fjalët vijnë nga Zotëria. Do shqyrtuar e pastaj duhet të hapemi, ta bëjmë hapin drejt besimit dhe t’i themi. Edhe një herë ju nxis që të hapeni. ”**E Atij që, në saje të fuqisë që**

**vepron në ne, mund të bëjë shumë më tepër se ne mund të kërkojmë ose edhe mund të mendojmë.“**  
{Ef 3,20)